

Intervistë me

Ivan

Ivanov

Drejtor i departamentit të IT/TC

Gratë në energjetikë

Anita

Jovanova

Koordinator i Bashkëpunimit Ndërkombëtar



MEPSO

PËRMBAJTJA

AKTUALITETE - 4

INTERVISTË - 8

PROJEKTE - 12

STACIONI I TRANSFORMUESIT - 21

GRATË NË ENERGJETIKË - 24

NJË DITË ME DEPARTAMENTIN E

REVITALIZIMIT- 29

KONFERANCA, DEBATE - 32

ORGANIZATA SINDIKALE E Sha MEPSO- 35

PUNONJËSIT DHE MEPSO - 36

LAJME NGA BOTA - 38

Botuar nga Sha MEPSO

Rruga Maksim Gorki nr.4.Shkup
Republika e Maqedonise se Veriut
www.mepso.com.mk

Drejtori Gjeneral:

Prof. d-r Burim Latifi

Pergatitja teknike:

Irina Daskallovska Qosevska
Violeta Z. Stojanovska
Emine Abazi Gashi
Selvije Ramani

AKTUALITETE

U VU NË FUNKSION TRANSFORMATORI I DYTË ENERGJETIK NË TS DUBROVË- FINALIZOHET EDHE NJË PROJEKT I NJËSISË ORrT-SË

Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për modernizimin dhe rritjen e efikasitetit të sistemit elektrotransmetues, në TS Dubrovë u realizua me sukses edhe një projekt tjetër. Bëhet fjalë për transportin, servisimin dhe instalimin e transformatorit ekzistues energjetik 400/110 kV, 300 MVA. Aktivitetet për çmontim dhe servis janë zhvilluar në fabrikën e bartësit të prokurimit Comel, në Beograd.

"Transformatori është element kyç për rritjen e fleksibilitetit dhe besueshmërisë së sistemit, veçanërisht duke pasur parasysh dinamikën e kycjes së kapaciteteve të reja energjetike, si dhe rritjen e sigurisë, me ç'rast pas një periudhe të gjatë u mundësua sërish funksionimi i trafostacionit me dy transformatorë energjetikë", theksoi

kryeinxhinieri i Njësisë së ORrT-së, Jane Gerasimovski.

Njësia ORrT, pavarësisht sfidave të shumta, finalizoi me sukses aktivitetet e filluara rreth dy vite më parë dhe edhe një herë konfirmoi rolin e saj kyç në realizimin e projekteve strategjike energjetike.



VAZHDON REVITALIZIMI I PAJISJEVE TË TENSIONIT TË LARTË NË TS MANASTIR 1



Departamenti për revitalizimin e pajisjeve të tensionit të lartë vazhdon me realizimin e aktiviteteve për zëvendësimin e ndarësve në trafostacionin TS Manastir 1 – 110 kV. Po demontohen ndarësit që kanë qenë në përdorim për disa dekada, ndërsa në vend të tyre po instalohet pajisje e re, ndarës të tipit "Rade Konçar".

Aktivitetet filluan në muajin mars të këtij viti në fushën e largpërçuesit TS Manastir 1 – TS Manastir 4 (largpërçuesi nr. 121/3), ku u zëvendësuan ndarësit në sistemin 1, sistemin 2 dhe ndarësi i linjës. Gjatë muajit prill u realizua edhe zëvendësimi i ndarësve të ETR 1 – TRAF0 1, në të dy sistemet. Punimet vazhdojnë në ETR 2 – TRAF0 2, ku gjithashtu do të kryhet zëvendësimi i ndarësve në sistemin 1 dhe sistemin 2. Deri më tani janë zëvendësuar ndarës në fushat elargpërçuesve TS Manastir 1 – TS Prilep 1 (linja nr. 109), TS Manastir1 – TS Manastir 4 (linja nr. 121/3) dhe TRAF0 1. Në periudhën e ardhshme do të vijojë zëvendësimi edhe në fushat TS Manastir 1 – TS Sopotnicë, fusha lidhëse matëse, si dhe në të dy fushat e largpërçuesve TS Manastir 1 – TS Manastir 2 me numrat e linjave 136A dhe 136B.

AKTUALITETE

VENDOSJET GURTHEMELI I INTERKONEKSIONIT 400 Kv MAQEDONIA E VERIUT-SHQIPERIA



Kryeministri, ministra nga vendi dhe jashtë vendit, kryetarë komunash, përfaqësues të institucioneve financiare ndërkombëtare, organe rregullatore, kompani dhe kontraktorë morën pjesë në fillimin e punimeve ndërtimore të linjës së transmetimit për lidhjen energjetike ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Shqipërisë.

Ngjarja tërhoqi vëmendje të madhe në opinionin publik, jo vetëm për rëndësinë e saj për rajonin, por edhe për faktin se projekti po riaktivizohet pas një periudhe të gjatë ndërprerjeje.

Projekti ka mbështetje të fuqishme nga BE dhe BERZH, të cilat kanë siguruar financim të konsiderueshëm. Linja e transmetimit në trase TS Manastir – TS Ohër – kufiri me Shqipërinë ka një gjatësi prej rreth 97,5 kilometrash dhe përfshin ndërtimin e 269 shtyllave. Si pjesë e Korridorit 8, kjo interkoneksion do të mundësojë furnizim më të sigurt me energji elektrike, rritje të shkëmbimeve ndërkufitare dhe integrim të plotë të sistemit elektroenergjetik të Maqedonisë me rrjetet rajonale dhe evropiane.



Ndërtimi është planifikuar të realizohet brenda një periudhe prej 900 ditësh.

AKTUALITETE**MEPSO FITON GRANT PREJ 2,4 MILIONË EURO NGA WBIF PËR
MODERNIZIMIN E SISTEMIT ELEKTROTRANSMETUES**

Sha MEPSO ka fituar një grant investues nga Western Balkan Investment Framework (WBIF) për realizimin e projektit "Advancing Operational Control in MEPSO's Transmission System". Qëllimi i projektit është përmirësimi i menaxhimit operativ dhe modernizimi i sistemeve për mbikëqyrje dhe kontroll të rrjetit elektrotransmetues. Projekti përfshin prokurimin dhe implementimin e një sistemi të ri SCADA/EMS (NDC dhe BDC), si dhe vendosjen e sistemeve lokale për mbikëqyrje dhe kontroll në trafostacione.

Sistemi aktual SCADA/EMS dhe sistemet e mbikëqyrjes në disa trafostacione të rrjetit të transmetimit në Maqedoninë e Veriut janë teknologjikisht të vjetruara dhe janë në fund të ciklit të tyre jetësor, gjë që sjell besueshmëri më të ulët, disponueshmëri të kufizuar të të dhënave dhe rritje të rrezikut për menaxhim të sigurt të sistemit elektroenergjetik. Sistemi i ri do të

mundësojë besueshmëri më të lartë në menaxhimin e sistemit elektroenergjetik, të dhëna të sakta në kohë reale dhe mjete të avancuara për analizë dhe parashikim të konsumit.

Investimi në modernizimin e sistemit SCADA/EMS dhe automatizimin e nënstacioneve është thelbësor për sigurimin e një transmetimi të qëndrueshëm dhe të sigurt të energjisë elektrike, rritjen e efikasitetit operacional dhe harmonizimin me standardet e ENTSO-E dhe BE-së. Projekti do të mundësojë zbulim dhe menaxhim më të shpejtë të defekteve, integrim më të mirë të burimeve të rinovueshme të energjisë, fleksibilitet më të madh dhe ulje të ndjeshme të rreziqeve nga ndërprerjet e sistemit.

Në këtë mënyrë, investimi përfaqëson një hap kyç drejt forcimit të sigurisë energjetike, transformimit digjital dhe mbështetjes së tranzicionit afatgjatë energjetik të vendit.

**SHA MEPSO MERR PJESË AKTIVE NË KRIJIMIN E POLITIKAVE
ENERGJETIKE EVROPIANE**

Drejtori gjeneral Burim Ljatifit mori pjesë në Asambleenë e përgjithshme dhe në CEO Strategic Workshop të ENTSO-E në Bruksel, ku u shqyrtuan çështjet kryesore për zhvillimin e ardhshëm të sistemit elektroenergjetik evropian.

Në fokus të diskutimeve ishin Grids Package evropian dhe kuadri legjislativ, roli i operatorëve të sistemeve të transmetimit në funksionimin e tregut të energjisë elektrike, si dhe sfidat që lidhen me sigurinë e sistemit, tranzicionin energjetik dhe dekarbonizimin. Gjithashtu, u theksua nevoja për bashkëpunim më të fuqishëm rajonal, rritje të investimeve në infrastrukturën e transmetimit dhe menaxhim më efikas të rrjetit.

Pjesëmarrja në këto takime i mundëson Sha MEPSO të kontribuojë në mënyrë aktive në drejtimet strategjike në nivel evropian dhe të harmonizohet në kohë me kërkesat e ardhshme rregullatore dhe operative në sektorin elektroenergjetik.



AKTUALITETE

MAQEDONIA ME PLAN STRATEGJIK PËR ENERGJI DHE KLIMË DERI NË VITIN 2030

Qeveria e Maqedonisë ka miratuar Planin e integruar nacional për energji dhe klimë për periudhën 2025–2030, me qëllim përforcimin e stabilitetit energjetik dhe harmonizimin me politikat evropiane. Plani përfshin 61 masa të orientuara drejt efikasitetit energjetik, sigurisë, zhvillimit të tregut të energjisë dhe inovacionit.

Fokusi kryesor është vendosur në uljen e emetimeve të gazrave serrë, rritjen e pjesëmarrjes së burimeve të rinovueshme dhe përmirësimin e efikasitetit energjetik. Autoritetet paralajmërojnë rritje të investimeve në energjinë diellore, të erës dhe hidroenergjinë, zhvillimin e sistemeve për ruajtjen e energjisë, modernizimin e infrastrukturës dhe heqjen graduale nga qymyri.

Paralelisht, parashikohet forcimi i sigurisë energjetike përmes diversifikimit të burimeve dhe bashkëpunimit rajonal. Dokumenti është



përgatitur me pjesëmarrjen e institucioneve, ekspertëve dhe partnerëve ndërkombëtarë, dhe i është nënshtruar edhe vlerësimit strategjik të ndikimit në mjedis.

Zbatimi i tij pritet të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së mjedisit, tërheqjen e investimeve të reja dhe rritjen ekonomike. Megjithatë, disa ekspertë paralajmërojnë se pa rritje të prodhimit vendor të energjisë elektrike, vendi do të mbetet i varur nga importi dhe goditjet e çmimeve në treg.



TRANSFORMIMI DIGJITAL NË SHËRBIM TË NJË SISTEMI ELEKTROENERGJETIK TË SIGURT DHE STABIL



Transformimi digjital paraqet një nga shtytësit kryesorë për zhvillimin e sistemit modern energjetik. Në kushte të kërkesave gjithnjë në rritje për siguri, besueshmëri dhe efikasitet, roli i sistemeve të IT-së dhe infrastrukturës telekomunikuese në funksionimin e SHA MEPSO bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Modernizimi i rrjeteve, forcimi i sigurisë kibernetike dhe implementimi i teknologjive të reja janë pjesë e prioriteteve që kontribuojnë drejtpërdrejt në stabilitetin e sistemit. Për projektet aktuale, sfidat dhe planet e ardhshme të sektorit IT/TK, bisedojmë me drejtorin Ivan Ivanov.

MEPSO realizon investime të rëndësishme në modernizimin e teknologjive informative dhe infrastrukturës telekomunikuese. Cilat projekte strategjike do t'i veçonit si prioritare dhe çfarë ndikimi kanë ato në funksionimin e kompanisë? A ka tashmë përfitime të dukshme?

► Gjatë periudhës së kaluar u fokusuar në modernizimin e infrastrukturës kryesore të IT-së dhe telekomunikacionit. Prioritet ishte rritja e sigurisë, disponueshmërisë dhe efikasitetit të sistemeve. Do të veçoja projektet për avancimin e infrastrukturës së rrjetit, modernizimin e kapaciteteve ekzistuese të IT-së, si dhe ndërtimin e një qendre moderne për rikuperim nga katastrofat (Disaster Recovery Center), e zhvilluar

në përputhje me standardet relevante dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Ky kapacitet ka rëndësi të veçantë për sigurimin e vazhdimësisë së biznesit, rikuperimin e shpejtë të sistemeve kritike dhe rritjen e qëndrueshmërisë së infrastrukturës në raste të ngjarjeve të paparashikuara. Përfitimet tashmë janë të dukshme përmes besueshmërisë më të lartë të sistemeve, efikasitetit të përmirësuar operacional dhe uljes së ndjeshme të rreziqeve nga ndërprerjet apo incidentet.

Sektori energjetik është infrastrukturë kritike me rrezik të shtuar nga kërcënimet kibernetike. Si e strukturoni qasjen ndaj sigurisë kibernetike dhe cilat janë sfidat kryesore në mbrojtjen e sistemeve ICT me të cilat përballeni?

► HQasja jonë ndaj sigurisë kibernetike është e strukturuar dhe bazohet në parimet e parandalimit, detektimit dhe reagimit në kohë. Në këtë drejtim, aktivitetet tona i harmonizojmë me kornizën rregullatore nacionale në fuqi, përfshirë rregullat për siguri kibernetike të miratuara nga Komisioni Rregullator për Energjetikë, si dhe me Ligjin për sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve informative, i cili vendos një kornizë moderne të harmonizuar me praktikatat evropiane.

Në vazhdimësi punojmë për përf forcimin e kontroleve të sigurisë, monitorimin e ngjarjeve, menaxhimin e rreziqeve dhe ngritjen e vetëdijes tek të punësuarit. Sfidat kryesore mbeten dinamika dhe sofistikimi i kërcënimeve, mbrojtja e sistemeve komplekse dhe të ndërlidhura, si dhe nevoja për harmonizim të vazhdueshëm me kërkesat rregullatore.

Në të ardhmen, konsiderojmë se përdorimi i inteligjencës artificiale do të jetë pjesë e

pashmangshme e sigurisë kibernetike, veçanërisht në aspektin e detektimit më të shpejtë të anomalive, analizës së kërcënimeve, automatizimit të reagimit dhe mbrojtjes proaktive të infrastrukturës kritike.



Sa janë të integruara digjitalizimi dhe automatizimi në proceset e punës së MEPSO-s dhe cilët janë hapat e ardhshëm në këtë drejtim??

► Digjitalizimi është një proces që gradualisht po intensifikohet dhe paraqet një nga prioritetet kryesore në menaxhimin modern korporativ. Tashmë janë implementuar zgjidhje që kontribuojnë në efikasitet më të madh, kontroll më të mirë dhe menaxhim më efektiv të proceseve.

Në periudhën e ardhshme, fokus i veçantë do t'i kushtohet zëvendësimit të zgjidhjes ekzistuese për Sistemin Informativ të Biznesit, DMS dhe arkivimin elektronik, me një sistem të ri, më modern, më të integruar dhe më të sigurt. Qëllimi është që proceset e punës të pasqyrohen realisht në mjedisin digjital, përkatësisht në hapësirën kibernetike, përmes automatizimit, gjurmueshmërisë më të mirë, rrjedhës më të shpejtë të informacionit dhe marrjes më efektive të vendimeve të bazuara në të dhëna relevante dhe në kohë.

Në këtë mënyrë do të krijohet baza për një transformim digjital edhe më të avancuar dhe për një nivel më të lartë të efikasitetit operacional në funksionimin e përgjithshëm të kompanisë

Cili është roli i infrastrukturës telekomunikuese në sigurimin e transmetimit të sigurt dhe stabil të energjisë elektrike?

► Infrastruktura telekomunikuese është baza për funksionimin stabil të sistemit elektroenergjetik. Ajo mundëson shkëmbim të sigurt, të shpejtë dhe të vazhdueshëm të të dhënave ndërmjet

elementeve të ndryshme të sistemit, gjë që është thelbësore për menaxhimin, monitorimin dhe reagimin në kohë reale.

Gjatë periudhës së kaluar realizuam një avancim të rëndësishëm të infrastrukturës telekomunikuese, me implementimin e zgjidhjeve moderne, rritjen e kapaciteteve transmetuese dhe redundancë shtesë të lidhjeve të komunikimit. Njëkohësisht, u arrit ulja e latencës, gjë që ka rëndësi të veçantë për menaxhimin e sigurt dhe efikas të sistemeve kritike në kohë reale.

Këto investime kontribuojnë drejtpërdrejt në besueshmëri, disponueshmëri dhe qëndrueshmëri më të lartë të të gjithë sistemit elektroenergjetik.

Si zhvillohet koordinimi ndërmjet IT-së, TK-së, OT-së (Operational Technology) dhe sektorëve të tjerë në kompani, veçanërisht gjatë implementimit të zgjidhjeve të reja teknologjike?

► Koordinimi bazohet në bashkëpunim të ngushtë dhe procese të përcaktuara qartë. Gjatë implementimit të zgjidhjeve të reja përfshihen të gjithë sektorët relevantë me qëllim që të sigurohet harmonizim, interoperabilitet dhe siguri. Kjo qasje e integruar është thelbësore për implementimin e suksesshëm të teknologjive komplekse.

Veçanërisht i rëndësishëm është koordinimi gjatë menaxhimit të proceseve që zhvillohen në kohë reale, ku shkëmbimi në kohë i informacionit dhe veprimi i sinkronizuar janë me rëndësi thelbësore për stabilitetin e sistemit. Gjithashtu, koordinimi është më i dukshëm gjatë implementimit të projekteve të sigurisë kibernetike, ku nevojitet një qasje holistike, duke pasur parasysh se këto sisteme janë funksionalisht dhe operacionalisht të ndërvarura.

Pikërisht për këtë arsye, menaxhimi modern i infrastrukturës kritike nënkupton bashkëpunim të integruar ndërmjet IT-së, telekomunikacionit, teknologjive operative dhe strukturave të tjera të biznesit.

Sa e rëndësishme është harmonizimi me direktivat dhe rregullat evropiane dhe si pozicionohet MEPSO në raport me zbatimin e tyre?

► Harmonizimi me direktivat evropiane, standardet dhe rregullat operative është me

rëndësi thelbësore, veçanërisht për një operator si MEPSO. Si operator i sistemit të transmetimit, MEPSO është drejtpërdrejt i interkonektuar me rrjetin rajonal dhe evropian elektroenergjetik përmes ENTSO-E, për këtë arsye është e domosdoshme ndjekja dhe zbatimi i vazhdueshëm i rregullave, rekomandimeve dhe udhëzimeve teknike që burojnë nga kjo kornizë.

Një harmonizim i tillë nuk është vetëm detyrim rregullator, por edhe parakusht për funksionim të sigurt ndërkuftar, stabilitet të sistemit dhe koordinim efikas me operatorët e tjerë në Evropë. Njëkohësisht, ai kontribuon në forcimin e besimit institucional dhe në confirmimin e MEPSO-s si partner kredibil dhe i besueshëm në hapësirën energjetike evropiane.

Sa i përket pozicionimit, mund të them se MEPSO punon në mënyrë aktive për avancimin e vazhdueshëm të kapaciteteve dhe proceseve të veta, me orientim të qartë drejt praktikave moderne evropiane, standardeve të larta të sigurisë dhe forcimit të mëtejshëm të rolit të saj në ndërlidhjen rajonale energjetike.

Cilat zgjidhje teknologjike dhe qasje i zbatoni për rritjen e rezistencës dhe sigurisë së sistemeve ICT?

► Fokusi është në vendosjen dhe avancimin e vazhdueshëm të kontrolleve shumështrësore të sigurisë, segmentimin e rrjeteve, testimet e rregullta dhe përmirësimin e proceseve për menaxhimin e incidenteve. Në kuadër të aktiviteteve të fundit janë implementuar zgjidhje moderne si EDR (Endpoint Detection and Response) dhe SIEM (Security Information and Event Management), me qëllim të detektimit, analizës dhe reagimit më efikas ndaj ngjarjeve të sigurisë.

Paralelisht me investimet teknologjike, vëmendje e konsiderueshme i kushtohet ndërtimit të kapaciteteve të brendshme përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe avancimit profesional të stafit teknik, pasi faktori njerëzor është element kyç në ruajtjen e një niveli të lartë të rezistencës kibernetike.

Në periudhën e ardhshme është planifikuar edhe implementimi i një Security Operations Center

(SOC), përkatësisht një qendër të centralizuar për monitorim dhe menaxhim të kërcënimeve kibernetike, e cila do të forcojë më tej aftësitë për mbrojtje proaktive dhe reagim në kohë.

Këto qasje mundësojnë rezistencë më të madhe të sistemeve, rikuperim më të shpejtë në rast të ndërprerjeve dhe nivel më të lartë të sigurisë operative.



A ka MEPSO kapacitete të vendosura të centralizuara për monitorim dhe menaxhim të incidenteve të sigurisë, dhe si zhvillohet ky proces në praktikë?

► Kemi kapacitete të vendosura për monitorim të centralizuar dhe menaxhim të ngjarjeve të sigurisë. Procesi përfshin monitorim të vazhdueshëm, analizë dhe reagim në kohë, me procedurë të përcaktuara qartë për menaxhimin e incidenteve dhe minimizimin e ndikimit të tyre.

Njëkohësisht, janë formuar edhe ekipe të brendshme për reagim ndaj incidenteve, si dhe është vendosur një sistem për raportimin e incidenteve kibernetike dhe aktiviteteve të dyshimta nga ana e të punësuarve, gjë që mundëson detektim më të shpejtë dhe reagim të koordinuar.

Megjithatë, duhet theksuar realisht se sigurimi i kuadrit me kualifikim të lartë për monitorim 24/7 paraqet sfida, e cila është e pranishme edhe në tregun më të gjerë. Pikërisht për këtë arsye, në periudhën e ardhshme planifikojmë forcimin shtesë të këtij segmenti përmes bashkëpunimit me një palë të tretë të specializuar, me qëllim sigurimin e mbulimit të vazhdueshëm, monitorimit të avancuar dhe reagimit më të shpejtë ndaj kërcënimeve potenciale.

Me një model të tillë të kombinuar të kapaciteteve të brendshme dhe ekspertizës së jashtme, qëllimi

është të sigurojmë një nivel edhe më të lartë të rezistencës kibernetike dhe sigurisë operative..

Cili është roli i teknologjive cloud dhe arkitekturave moderne të IT-së në strategjinë tuaj, dhe si adresohen aspektet e sigurisë që lidhen me to?

► *Teknologjitë cloud shqyrtohen si pjesë e strategjisë moderne të IT-së, veçanërisht me qëllim të rritjes së fleksibilitetit, shkallëzueshmërisë dhe efikasitetit operacional. Në këtë drejtim, një pjesë e shërbimeve dhe proceseve tashmë realizohen në mjedis cloud, siç është Microsoft 365, ndërsa aktualisht jemi në fazën e testimit dhe shqyrtimit të zgjidhjeve të tjera të përshtatshme të shërbimeve.*

Gjatë kësaj, siguria mbetet prioritet, përmes përzgjedhjes së kujdesshme të teknologjive, kontrolleve adekuate të qasjes, mbrojtjes së të dhënave dhe harmonizimit me standardet relevante dhe praktikën më të mira. Qëllimi është që qasja cloud të përdoret në mënyrë që të sjellë efikasitet më të madh, duke ruajtur njëkohësisht nivelin e nevojshëm të sigurisë dhe kontrollit.

Duke pasur parasysh zhvillimin e shpejtë të teknologjisë, si e zhvillon kapitalin njerëzor në sektorin IT/TK? A investohet në edukim dhe certifikim?

► *Vazhdojmë të investojmë në zhvillimin e kuadrit përmes trajnimeve, certifikimeve dhe avancimit praktik profesional. Jemi të vetëdijshëm se kuadri cilësor dhe i trajnuar është faktor kyç për stabilitetin, sigurinë dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve, prandaj kjo fushë ka prioritet të lartë.*

Parimi i përmirësimit të vazhdueshëm (continual improvement) është pjesë përbërëse e strategjisë sonë për zhvillimin e sektorit të IT-së dhe telekomunikacionit. Kjo nënkupton ndjekje të vazhdueshme të trendeve të reja teknologjike, adaptim të praktikave moderne dhe përgatitje në kohë për ndryshimet që sjell tregu, veçanërisht në një periudhë kur inteligjenca artificiale po integrohet gjithnjë e më shumë në proceset dhe zgjidhjet e IT-së.

Në këtë drejtim, investojmë edhe në trajnime teknike të specializuara për personelin profesional, por edhe në programe për ngritjen e vetëdijes për sigurinë tek të gjithë të punësuarit në kompani. Qasja jonë është se teknologjia,

proceset dhe njerëzit duhet të zhvillohen paralelisht, në mënyrë që të sigurohet sukses afatgjatë.



"Teknologjia, proceset dhe njerëzit duhet të zhvillohen paralelisht, për të siguruar sukses afatgjatë."

Cila është vizioni juaj për zhvillimin e sektorit IT dhe të telekomunikacionit në MEPSO në vitet e ardhshme?

► *Në periudhën e ardhshme, vizioni është i orientuar drejt transformimit të mëtejshëm digjital, forcimit të sigurisë kibernetike dhe modernizimit të vazhdueshëm të infrastrukturës IT dhe telekomunikuese. Qëllimi është të sigurohet një nivel më i lartë i sigurisë, efikasitetit dhe gatishmërisë operacionale për sfidat e ardhshme në sektorin energjetik.*

Një fokus i veçantë do t'i kushtohet përgatitjes për epokën e re të inteligjencës artificiale, ku sistemet IT gjithnjë e më shumë do të bazohen në të dhëna, automatizim dhe analitikë të avancuar. Në këtë drejtim, prioritet kyç është zhvillimi i kapaciteteve të brendshme, njohurive dhe ekspertizës, në mënyrë që organizata të mund të kuptojë, implementojë dhe menaxhojë në mënyrë të pavarur trendet e reja teknologjike.

Për më tepër, vizioni përfshin edhe forcimin e reziliencës së sistemeve, integrimin më të madh të mekanizmave të sigurisë në të gjitha proceset IT, si dhe kalimin gradual drejt arkitekturave më agile dhe të orientuara nga të dhënat. Në këtë mënyrë, MEPSO do të mbetet teknikisht i qëndrueshëm, i sigurt dhe i përgatitur për ndryshimet dinamike në ekosistemin energjetik dhe digjital.

PROJEKTE

MODERNIZIMI I SISTEMEVE PËR MBIKËQYRJE DHE MENAXHIM NË DISTANCË NË TRAFOSTACIONE

Shkruan Marjan Janevski, ref. përgjegjës për legjislacion tekniko-juridik në Shërbimin për sisteme të mbikëqyrjes dhe menaxhimit në distancë të EEO, Departamenti IT



Duke ndjekur trendet botërore për modernizimin e pajisjeve për mbikëqyrje dhe menaxhim në distancë tek operatorët e transmetimit, Shërbimi për sisteme të mbikëqyrjes dhe menaxhimit në distancë të EEO-së, që është pjesë e Departamentit të IT-së pranë Degës OSEE të ShA МЕРСО, ndërmerr një hap të rëndësishëm për modernizimin dhe avancimin e disa trafostacioneve me pajisje bashkëkohore për mbikëqyrje dhe menaxhim.

Konkretisht, u realizua modernizimi dhe përshtatja e pajisjeve në TS Resnjë, TS Dellçevë dhe TS Strumicë 1. Qëllimi i rikonstruktimit dhe modernizimit është që përmes instalimit të sistemit Substation Automation and Control System (SACS) – sistem për mbikëqyrje dhe menaxhim të nënstacioneve të lartpërmendura, i bazuar në pajisje Remote Terminal Unit (RTU), të mundësohet mbikëqyrja dhe menaxhimi i të gjitha fushave në këto stacione transformatorike.

Të tri trafostacionet janë në pronësi të EVN-së dhe nuk kanë personel të përhershëm, (Përveç trafostacionit TS Strumica 1) ndërsa me pajisjet e tensionit të lartë menaxhojnë dispeçerët nga Qendra Nationale Dispeçerike në ShA МЕРСО dhe personat përgjegjës lokalë nga kompania. Në këto trafostacione edhe më parë ishte instaluar pajisje për mbikëqyrje dhe menaxhim në distancë, por për shkak të amortizimit dhe jofunksionalitetit të saj, u paraqit nevoja për zëvendësimin me pajisje të reja dhe më moderne.

Me termin “mbikëqyrje dhe menaxhim në distancë” nënkuptohet kontroll i drejtpërdrejtë mbi gjendjen e pajisjeve të tensionit të lartë në trafostacion, statusin e pajisjeve, saktësinë e matjeve të linjave dhe transformatorëve, si dhe alarmet aktive nëse ekzistojnë, e gjitha kjo në kohë reale. Në këtë mënyrë, dispeçerit kujdestar i mundësohet monitorim dhe kontroll i plotë i trafostacionit në kohë reale dhe menaxhim më më i lehtë i gjithë sistemit energjetik në shtet. Dispeçeri përmes pajisjeve për mbikëqyrje dhe menaxhim në distancë mund të komandojë nga QND-ja, përkatësisht të kyçë dhe ç’kyçë linja dhe



transformatorë, varësisht nga gjendja në sistemin elektroenergjetik.



Në të tri trafostacionet për herë të parë në kuadër të të gjithë EES-së u u aplikua i njëjti projekt pilot për instalimin e pajisjeve për mbikëqyrje dhe

menaxhim në distancë, i zhvilluar dhe konceptuar nga punonjësit e Shërbimit për sisteme të mbikëqyrjes dhe menaxhimit në distancë. Përkatesisht, në kabinetin e menaxhimit, përveç Remote Terminal Unit (RTU), është instaluar edhe LCP (Local Control Panel) dhe pajisja për sinjalizim SACO.

Pajisjet e instaluar janë nga prodhues të njohur: në TS Resnjë dhe TS Strumicë 1 RTU HITACHI, ndërsa në TS Dellçevë është instaluar RTU nga Schweitzer Engineering Laboratories.



Funksioni i RTU-së është që vazhdimisht, nga të gjitha fushat në trafostacion, t'i mbledhë të gjitha informacionet (statuset, matjet dhe alarmet), të cilat përmes kablllove sillen në kabinetin e menaxhimit, digjitalizohen në RTU dhe përmes mediumit transmetues (optikë në pronësi të АД МЕРСО) të transmetohen dhe prezantohen në SCADA në QKD. Gjithashtu, dispeçeri në QKD mund në distancë të japë komandë për kyçjen ose çkyçjen e ndërprerësve ose ndarësve, gjë që përmes RTU-së realizohet në TS.

Funksioni i LCP-së është që lokalisht të shihet statusi i pajisjeve në të gjitha fushat, të shihen matjet e instrumenteve analoge matëse, të shihen alarmet aktive në pajisjen e sinjalizimit SACO,

ndërsa nga vetë kabineti i menaxhimit personi i autorizuar mund lokalisht të komandojë me pajisjet e tensionit të lartë, veçanërisht gjatë servisimit të pajisjeve ose gjatë eliminimit të defekteve, kur është i domosdoshëm menaxhimi me ndërprerësit dhe ndarësit.

Në kuadër të të tri projekteve, u zëvendësuan kabllo të vjetra dhe u instaluan kablo të reja sinjalizuese dhe komanduese nga pajisjet e tensionit të lartë, si dhe kablo të reja nga transformatorët matës të rrymës dhe tensionit, deri te kabinetet e menaxhimit në TS Resnjë, TS Dellçevë dhe TS Strumicë 1. Me këtë rast, u realizuan edhe punime shtesë ndërtimore, si gërmime dhe betonim i kanaleve pas vendosjes së kablllove. Punimet në terren shpesh zhvilloheshin paralelisht në më shumë trafostacione, madje disa herë edhe në orët e hershme të mëngjesit, për shkak të kushteve specifike energjetike në periudha të caktuara kohore.

Projektet filluan me realizim në maj 2025 dhe përfunduan me sukses në maj 2026, në përputhje me afatet e dakorduara.

Zbatues i punimeve në TS Resnjë dhe TS Strumicë 1 ishte SEM Shkup, ndërsa në TS Dellçevë BENNING PSAM ShPK. Nga ana e tyre, të gjitha aktivitetet u realizuan në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit.

Me realizimin e këtyre projekteve është bërë një hap i rëndësishëm drejt një sistemi elektroenergjetik më të sigurt, më stabil dhe më modern, i menaxhuar nga ShA MEPSO.

PROJEKTE

RIKONSTRUIMI DHE MODERNIZIMI ENERGJETIK I NDËRTESAVE KOMANDUESE NË TRI NËNSTACIONE

Shkruan: Sllajana Kollozov, menaxhere projekti në Departamentin për Investime dhe Zhvillim

MEPSO po realizon një projekt për rikonstruktimin e ndërtesave komanduese në nënstacionet 400/110 kV TS "Shkup 4", TS "Shkup 1/5" dhe TS "Dubrovë", me qëllim të përmirësimit të efikasitetit energjetik, modernizimit të objekteve, krijimit të kushteve më të mira të punës për punonjësit, si dhe sigurimit të qasjes së papenguar për personat me aftësi të kufizuara.

Bëhet fjalë për objekte të ndërtuara gjatë viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluar, të cilat sot kanë nevojë për rinovim teknik dhe energjetik në përputhje me standardet bashkëkohore. Projekti ka rëndësi të shumëfishtë. Përveç përmirësimit të funksionalitetit dhe sigurisë së objekteve, ai do të kontribuojë edhe në uljen e konsumit të energjisë elektrike, integrimin e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe reduktimin e emetimeve të CO₂.



Në të tri ndërtesat komanduese janë planifikuar punime ndërtimore, elektroteknike dhe makinerike, instalimi i sistemeve të reja, përmirësimi i izolimit termik, rikonstruktimi i konstruksioneve të kulmit dhe modernizimi i sistemeve të ngrohjes, ftohjes dhe ndriçimit. Gjithashtu, parashihet zëvendësimi i zdrukthtarisë së amortizuar me zgjidhje të reja energjetikisht efikase, si dhe instalimi i ndriçimit

LED dhe sistemeve moderne të klimatizimit dhe ventilimit. Një segment veçanërisht i rëndësishëm i projektit është vendosja e centraleve fotovoltaike me fuqi të instaluar prej 40 kWp në secilin objekt. Në këtë mënyrë, një pjesë e energjisë elektrike të nevojshme do të sigurohet nga burime të rinovueshme, gjë që do të kontribuojë shtesë në rritjen e pavarësisë energjetike dhe funksionimin më të qëndrueshëm të objekteve

Modernizim dhe efikasitet i përmirësuar energjetik në TS "Shkup 4"



Në ndërtesën komanduese të TS "Shkup 4", projekti përfshin përmirësimin e karakteristikave energjetike dhe modernizimin e sistemeve ekzistuese. Parashihet mbrojtje termike e objektit përmes realizimit të një termo-fasade të re, sanimit të konstruksionit të kulmit dhe vendosjes së termoizolimit në të gjithë sipërfaqen e tij, zëvendësimin të dritareve dhe dyerve të amortizuara me zgjidhje të reja energjetikisht efikase, si dhe instalimit të sistemeve moderne të ngrohjes dhe ftohjes.

Në objekt do të instalohet një sistem fotovoltaike me fuqi prej 40 kWp për nevoja vetanake, si dhe një sistem solar për furnizim me ujë të ngrohtë sanitar. Gjithashtu, janë planifikuar masa për përmirësimin e qasjes për

personat me aftësi të kufizuara, përmes ndërtimit të një rampe hyrëse dhe platforme për lëvizje ndërmjet kateve.

Sisteme moderne dhe zgjidhje të qëndrueshme në TS "Shkup 1/5"



Në TS "Shkup 1/5", përveç realizimit të një termo-fasade të re, zëvendësimit të dritareve dhe dyerve ekzistuese, rinovimit të mbulesës së kulmit dhe sanimit të konstruksionit të tij, projekti përfshin edhe aplikimin e pompave termike, kolektorëve solarë dhe sistemeve të kombinuara për ngrohje dhe ftohje, me çka do të rritet më tej efikasiteti energjetik i objektit. Njëkohësisht, janë planifikuar zgjidhje për qasje dhe përdorim më të lehtë të objektit nga personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, është paraparë instalimi i një centrali fotovoltaike me fuqi prej 40 kWp për nevoja vetanake.



Rinovim i infrastrukturës dhe siguri e shtuar në TS "Dubrovë"



Në TS "Dubrovë", rikonstruktimi përfshin sanimin e kulmit, realizimin e një termo-fasade të re dhe zëvendësimin e dritareve dhe dyerve të amortizuara me sisteme moderne energjetikisht efikase.

Për më tepër, janë planifikuar kolektorë solarë për ujë të ngrohtë sanitar, sisteme të reja të ngrohjes dhe ftohjes, si dhe përmirësimi i instalimeve elektroteknike dhe sistemeve mbrojtëse të objektit. Gjithashtu, parashihet instalimi i një centrali fotovoltaike me fuqi prej 40 kWp për nevoja vetanake.

Për të siguruar lëvizje dhe qasje të papenguar për personat me aftësi të kufizuara në objekt, është paraparë një zgjidhje përkatëse infrastrukturorë.

Me realizimin e këtij projekti, MEPSO vazhdon aktivitetet e orientuara drejt modernizimit të sistemit elektroenergjetik të transmetimit dhe zbatimit të zgjidhjeve bashkëkohore për efikasitet energjetik.

Rikonstruktimi i ndërtesave komanduese përfaqëson një investim jo vetëm në infrastrukturë, por edhe në krijimin e kushteve më të mira të punës, uljen e ndikimit ndaj mjedisit jetësor dhe ndërtimin e një sistemi energjetik më të qëndrueshëm dhe më efikas.

PROJEKTE**NGA MODELIMI DERI TE DIGJITALIZIMI: AKTIVITETE TË REJA
ZHVILLIMORE NË SHA MEPSO**

Shkruajnë: Branka Vasiq, Marjanço Çangovski, Stefanija Spasovska

Në kushtet e ndryshimeve gjithnjë e më të theksuara në sektorin elektroenergjetik dhe nevojës për menaxhim më fleksibël dhe më efikas të sistemit, MEPSO punon vazhdimisht për modernizimin dhe avancimin e sistemit kombëtar të transmetimit të energjisë elektrike. Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me RTE International, e financuar nga French Development Agency, gjatë periudhës së kaluar janë realizuar një sërë aktivitete të orientuara drejt forcimit të kapaciteteve teknike dhe operative të kompanisë, përmes aplikimit të mjeteve të reja, mbështetjes së ekspertëve dhe transferimit të njohurive.



Partneriteti përfshin disa fusha kyçe për zhvillimin e ardhshëm të sistemit elektroenergjetik në Maqedoninë e Veriut. Në kuadër të projektit është zhvilluar një model në Antares Simulator – një mjet i avancuar për modelimin dhe simulimin e sistemeve elektroenergjetike – përmes të cilit MEPSO përgatiti Studimin e parë Kombëtar për Adekuatshmërinë e Burimeve (NRAA).

Për më tepër, përmes këtij bashkëpunimi është zhvilluar një metodologji inovative për llogaritjen dhe parashikimin e rezervave sistimore, e bazuar në modele të mësimi makinerik. Kjo metodologji mundëson projeksione afatgjata të nevojave për rezerva sistimore, duke marrë në konsideratë trendet në konsum, rrjedhat ndërkuftare dhe rritjen e burimeve të rinovueshme të energjisë. Në fushën e balancimit të sistemit u organizua një trajnim profesional me ekspertë nga operatori francez i transmetimit, të cilët ndanë përvojat dhe praktikën e tyre në menaxhimin e këtij procesi në Francë.

Një segment i rëndësishëm i projektit është edhe mbështetja për përmirësimin e parashikimit dhe menaxhimin të humbjeve në rrjetin e transmetimit. Përmes analizës së të dhënave historike dhe aplikimit të metodave bashkëkohore analitike, janë propozuar qasje të reja për rritjen e saktësisë së parashikimeve dhe optimizimin e proceseve të furnizimit me energji për mbulimin e humbjeve.



Bashkëpunimi ndërmjet MEPSO, French Development Agency dhe RTE International përfshin gjithashtu një projekt pilot për digjitalizimin e një nënstacioni 110 kV, në përputhje me standardin ndërkombëtar IEC 61850. Ky projekt përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të një infrastrukture transmetuese më efikase, më të sigurt dhe më fleksibile, të përgatitur për sfidat e ardhshme të tranzicionit energjetik. Përmes këtij partneriteti, MEPSO përfiton jo vetëm mbështetje teknike, por edhe transferim të vlefshëm të njohurive dhe ekspertizës nga një prej operatorëve më të avancuar të transmetimit në Evropë, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe harmonizimin e mëtejshëm me standardet evropiane.



Digjitalizimi si bazë për një sistem më të sigurt të transmetimit të energjisë elektrike

Nënstacioni digjital paraqet një koncept modern teknologjik për menaxhimin dhe monitorimin e objekteve elektroenergjetike. Përmes aplikimit të pajisjeve elektronike inteligjente, sistemeve moderne SCADA dhe infrastrukturës së avancuar të komunikimit, mundësohet monitorim më i shpejtë dhe më i saktë i gjendjes së rrjetit elektroenergjetik, si dhe reagim i automatizuar në rast të defekteve ose mbingarkesave të mundshme. Për MEPSO, si operator i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, digjitalizimi i nënstacioneve paraqet një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të rrjetit të transmetimit.

Vendosja e sistemeve të menaxhimit digjital në distancë mundëson monitorim dhe kontroll të vazhdueshëm në kohë reale, identifikim më të

shpejtë të problemeve dhe reduktim të kohës së nevojshme për ndërhyrje dhe analiza të ngjarjeve.

Përvoja nga Franca: Zgjidhje digjitale për një sistem modern të transmetimit të energjisë

Në kuadër të projektit për digjitalizimin e nënstacioneve, sipas marrëveshjes ndërmjet RTE International, French Development Agency dhe MEPSO, u realizua një vizitë profesionale në një nënstacion në Toul, Francë, ku RTE ka zbatuar zgjidhje moderne për digjitalizimin e sistemeve sekondare. Gjithashtu, në Lion u vizitua qendra për kërkim dhe trajnim e RTE-së, ku zhvillohen zgjidhje të reja teknologjike dhe realizohen trajnime të specializuara për punonjësit. Qëllimi i vizitës ishte njohja me zbatimin praktik të teknologjive digjitale në objektet e transmetimit të energjisë elektrike. Përshtypje të veçantë la qasja sistematike e RTE-së ndaj trajnimit të kuadrit teknik, si dhe niveli i lartë i organizimit në menaxhimin, mbrojtjen dhe monitorimin e objekteve energjetike. Gjatë shqyrtimit të zgjidhjeve teknike u konstatua se një pjesë e pajisjeve tashmë të instaluar dhe konceptet e punës janë të ngjashme me sistemet që tashmë aplikohen në MEPSO, Shkup.



Kjo paraqet konfirmim se kompania ndjek në mënyrë aktive trendet bashkëkohore teknologjike dhe investon vazhdimisht në modernizimin e infrastrukturës së saj. Vizita përbën një mundësi të rëndësishme për shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të mira, veçanërisht në fushën e zhvillimit të burimeve njerëzore dhe aplikimit të zgjidhjeve inovative në sektorin energjetik.

PROJEKTE

HARMONIZIMI I TREGUT NACIONAL TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME PAKETËN E INTEGRIMIT TË BE-së

Shkruan: Igor Stojanovski, Udhëheqës i Shërbimit për analizë të rrjetit, siguri operative dhe legjislacion në OSEE

Në drejtim të integrimit më të madh të tregut të energjisë elektrike, i cili do të mundësojë unifikimin e të gjitha tregjeve të tregtimit të energjisë elektrike (tregu afatgjatë, tregu "ditë përpara", tregu "brenda ditës" dhe tregu i energjisë balancuese) në një treg të vetëm të energjisë elektrike, përmes bashkimit të tregut të energjisë elektrike të BE-së dhe Maqedonisë së Veriut, është e domosdoshme transpozimi i plotë i Paketës për integrimin e tregut të energjisë elektrike.

Treguesit bazë dhe hapat për harmonizimin e tyre janë përcaktuar me Agjendën e reformave: Fusha

e politikës 2 – Tranzicioni energjetik/digjital, Reforma 2.1.1.1 "Harmonizimi me Paketën e integrimit të energjisë elektrike" dhe Ligji për Energjetikë(*) (Gazeta Zyrtare nr. 101/2025 dhe nr. 135/2025). Këto masa përfshijnë miratimin dhe integrimin e plotë të direktivave dhe rregulloreve të tregut të energjisë elektrike të BE-së në legjislacionin kombëtar, duke siguruar që tregu nacional i energjisë elektrike të harmonizohet me parimet dhe standardet e përcaktuara nga BE-ja, të definuara si Paketa për integrimin e tregut të energjisë elektrike (Electricity Integration Package).

Paketa për integrimin e tregut të energjisë elektrike përbëhet nga këto rregullore dhe direktiva evropiane:

#	Akti ligjor i BE-së	Fokusi kryesor	Palët përgjegjëse
1	Electricity Directive Regulation (EU) 2019/944	Organizimi i tregut, mbrojtja e konsumatorëve	MERT, MEPSO, EVN Distribuimi, KRrE
2	ACER Regulation Regulation (EU) 2019/942	Përcaktimi i rolit të ACER	MERT, ACER (E
3	Electricity Regulation (EU) 2019/943	Tregje të integruara të energjisë elektrike	nZ), KRrE
4	Risk Preparedness Regulation (EU) 2019/941	Menaxhimi i krizave në sektorin e energjisë elektrike	Qeveria, MEPSO, EVN Distribuimi, ENTSO-E

5	FCA GL Regulation (EU) 2016/1719	Tregtim sekondar (afatgjatë) i të drejtave të kapaciteteve	MEPSO, KRrE, JAO
6	CACM GL Regulation (EU) 2015/1222	Alokimi i kapaciteteve dhe menaxhimi i mbingarkesave për tregun “day-ahead” dhe “intraday”	MEPSO, MEMO, KRrE, ACER (EnZ)
7	EB GL Regulation (EU) 2017/2195	Shkëmbimi i energjisë balancuese	MEPSO, BSPs, BRPs, KRrE
8	SO GL Regulation (EU) 2017/1485	Siguria operationale e sistemit elektroenergjetik	MEPSO, përdoruesit e rrjetit të transmetimit, KRrE
9	ER NC Regulation (EU) 2017/2196	Operimi në kushte çrregullimesh dhe restaurimi i sistemit	MEPSO, përdoruesit e rrjetit të transmetimit, KRrE

PLANI AKSIONAR PËR REALIZIMIN

Harmonizimi i legjislacionit evropian me legjislacionin nacional është përcaktuar në Planin e veprimit të përgatitur më 28.11.2028 nga AETS, i cili parasheh që bashkimi i tregjeve të realizohet në fazat e mëposhtme:

Faza A: Transpozimi - Faza A përfshin përfundimin e transpozimit të akteve ligjore të EIP në legjislacionin nacional, duke përfshirë edhe legjislacionin sekondar dhe kodet e rrjetit.

Faza B: Njoftimi dhe verifikimi - Faza B përfshin njoftimin e organeve kompetente (Sekretariati i komunitetit energjetik) dhe verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore.

Faza C: Përgatitja për bashkimin e tregjeve - Faza C fokusohet në përgatitjen për lidhjen e tregjeve përmes konfirmimit të përputhshmërisë, nënshkrimit të marrëveshjeve dhe fillimit të projekteve për zbatimin e bashkimit të tregjeve, si dhe përgatitjes së TCM-ve.

Faza D: Varësitë rajonale dhe evropiane - Faza D trajton varësitë, përfshirë vendimet e ACER-it për integrimin e operatorëve dhe rajoneve të llogaritjes së kapaciteteve.

Me qëllim të përshpejtimit të realizimit të Reformës 2.1.1.1: Harmonizimi me Paketën e Integritit të Energjisë Elektrike për bashkimin e tregut të energjisë elektrike midis BE-së dhe Maqedonisë së Veriut, MEPSO ka përshtatur rregulloret nga Paketa e Integritit të Energjisë Elektrike që janë në kompetencën e tij, në përputhje me obligimet ligjore, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në ENTSO-E. Me këtë, është përmbyllur plotësisht faza e parë e bashkimit të tregut përmes miratimit të rregulloreve dhe akteve nënligjore që janë në kompetencën e MEPSO-s. Në periudhën në vijim, Ministria e Energjetikës, Minierave dhe Lëndëve të Para do të njoftojë Sekretariatit e komunitetit energjetik për miratimin e tyre, me çka do të nisë edhe procesi i verifikimit nga ana e tij.

PROJEKTE

GJELBËRIMI DHE DIGJITALIZIMI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT

Shkruan: Mentor Hamidi, udhëheqës i Shërbimit për menaxhimin e projekteve

Projekti "Gjelbërimi dhe digjitalizimi i rrjetit të transmetimit në rajonin Jugperëndimor dhe të Pellagonisë" paraqet një nga projektet kyçe energjetike të parashikuara në Strategjinë për zhvillimin e energjetikës së Maqedonisë së Veriut deri në vitin 2040 dhe në Planin nacional për energji dhe llimë (PNEK). Këto dokumente strategjike përcaktojnë vizionin afatgjatë për forcimin e sigurisë energjetike, përmirësimin e efikasitetit energjetik dhe rritjen e pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme të energjisë në sistemin nacional energjetik.

Qëllimi kryesor i projektit është rritja e kapacitetit të rrjetit elektrotransmetues për integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë përmes modernizimit të linjave ekzistuese të transmetimit me përçues bashkëkohorë me temperaturë të lartë (HTLS). Me këtë zgjidhje do të përmirësohet ndjeshëm stabiliteti dhe fuqia transmetuese e rrjetit, pa pasur nevojë për ndërtimin e traseve dhe shtyllave të reja.

Projekti ka rëndësi të theksuar rajonale dhe realizohet në bashkëpunim ndërmjet MEPSO dhe operatorit grek të sistemit të transmetimit, IPTO. Parashihet zëvendësimi i përçuesve ekzistues me të rinj, me kapacitet dukshëm më të madh transmetues, gjë që do të mundësojë transmetim më efikas dhe më të sigurt të energjisë elektrike. Me modernizimin e planifikuar pritet pothuajse dyfishim i kufirit maksimal termik, nga 1330 MVA aktualisht në rreth 2432 MVA. Segmenti prej 17.3 kilometrash nga TS Manastir 2 deri në kufirin shtetëror do të përfshihet në këtë modernizim, i cili është pjesë edhe e planit panevropian dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit.

Komponentë të tjerë të projektit janë edhe rikonstruktimi i linjave 110 kV si: HE Vrutok – TS Gostivar – TS Jegunovcë – TS Shkup 3 – TS Gjorçe Petrov – TS Shkup 5, si dhe linja TS Pollog – HE Vrutok – TS Shpile – TS Gllaboçicë – TS Strugë; digjitalizimi i TS Manastir 1 dhe Sopotnicë; implementimi i sistemit Dynamic Line Rating (DLR), si dhe rikonstruktimi dhe rehabilitimi i Qendrës Testuese në Ohrid.

Në kuadër të projektit do të përgatiten Studimi i fizibilitetit dhe studimi për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe aspektet sociale (ESIA), me qëllim përcaktimin e zgjidhjeve më optimale teknike dhe ekonomike. Studimet do të sigurojnë analizë të pavarur të aspekteve teknike, financiare dhe mjedisore të projektit, në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.



PREZANTIMI I STACIONEVE TRANSFORMUESE

TS DUBROVË – NJË NGA NYJET KRYESORE ENERGJETIKE NË SISTEMIN ELEKTROTRANSMETUES TË MAQEDONISË

Përgatiti: Irina Daskalovska Qosevska



TS Dubrovë paraqet një nga kapacitetet më të rëndësishme energjetike në kuadër të rrjetit të transmetimit të ShA MEPSO dhe është pjesë e të ashtuquajturit trekëndësh i madh (TS Manastir 2 – TS Dubrovë – TS Shkup 4 – TS Manastir 2), mbi bazën e të cilit është ndërtuar sistemi elektrotransmetues i Maqedonisë. E vënë në funksion në vitin 1978, TS Dubrovë për më shumë se katër dekada ka pasur një rol thelbësor në furnizimin stabil dhe transmetimin e energjisë elektrike në vend.

rëndësishëm në stabilitetin energjetik rajonal dhe shkëmbimin e energjisë elektrike.

Përveç rrjetit 400 kV, TS Dubrovë disponon edhe me 13 fusha aktive 110 kV dhe dy rezervë, përmes të cilave furnizohen disa kapacitete të rëndësishme industriale dhe energjetike, ndër të cilat: Negotinë, Buçim, FENI 1 dhe FENI 2, Biloku i TEC Negotinë, Kavadar, Valandovë, HEC Dren, si dhe furnizimi për nevojat e brendshme të TEC Negotinë.



Modernizimi dhe projektet e reja energjetike

BNë TS Dubrovë është në zhvillim e sipër një procedurë e gjerë për rindërtimin dhe modernizimin e impiantit. Tashmë është rikonstruktuar e gjithë pajisja 400 kV dhe 110 kV,

Ky trafostacion disponon me katër linja transmetimi 400 kV, ndër të cilat edhe linjën interkonektive TS Dubrovë – TS Selanik, e cila paraqet një lidhje të rëndësishme me sistemin elektrotransmetues të Greqisë dhe ka rol të





gjë që përmirëson ndjeshëm sigurinë, stabilitetin dhe funksionalitetin e sistemit.

Një projekt veçanërisht i rëndësishëm është instalimi i një pajisjeje për korigjimin e profilit të tensionit, ose të ashtuquajturit shunt reactor, që ka për qëllim korigjimin, përkatësisht uljen e vlerës së tensionit në anën 400 kV përmes konsumit të fuqisë reaktive në rrjetin e transmetimit. Ulja e vlerës së tensionit në anën 400 kV do të nënkuptojë përmirësim të kushteve të tensionit në sistem, duke pasur parasysh trendin e tensioneve të larta, problem ky rajonal nga i cili nuk përjashtohet as sistemi maqedonas i transmetimit të energjisë elektrike.

Një pajisje e tillë do të instalohet për herë të parë në Maqedoninë e Veriut dhe është pjesë e një studimi më të gjerë rajonal për instalimin e pajisjeve për korigjimin e profilit të tensionit në nyje të caktuara energjetike tek operatorët fqinjë të transmetimit. Përgatitjet për realizimin e këtij projekti historik tashmë kanë filluar, ndërsa një pjesë e pajisjeve të nevojshme ka mbërritur.



“TS Dubrovë është një pikë strategjike dhe e rëndësishme për sistemin elektrotransmetues të Maqedonisë. Me modernizimin dhe vendosjen e pajisjes për korigjimin e profilit të tensionit, ky trafostacion fiton një rëndësi edhe më të madhe në ruajtjen e stabilitetit të kushteve të tensionit dhe sigurisë së rrjetit të transmetimit”, vthekson udhëheqësi i TS-së Zoran Angelov, udhëheqësi i TS Dubrovë, i cili ka pas vetes një përvojë 35-veçare në sektorin energjetik.

Në kuadër të stacionit është i lidhur parku i erës VEC Dren, ndërsa dy fushat rezervë do të mundësojnë zhvillim të mëtejshëm dhe integrimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në sistemin e transmetimit.

Ekipi që funksionon 24 orë

Për funksionimin e pandërprerë të TS Dubrovë kujdeset një ekip prej 23 punonjësish, të organizuar në ndërrime, me prani dhe mbikëqyrje 24-orëshe. Ekipi përbëhet nga montues elektrik, elektrikistë të operimit, elektrikist (montues) mobil, magazinier, evidencues, punëtor i përgjithshëm dhe sigurim.



Dita e punës fillon herët. Çdo mëngjes në orën 7 kryhet një inspektim i detajuar i impiantit dhe kontrolli i pajisjeve primare dhe sekondare. Çdo ndryshim apo vërejtje e mundshme evidentohet në planin mujor të mirëmbajtjes së trafostacionit.

“Puna në një trafostacion kërkon përgjegjësi maksimale, përqendrim dhe koordinim ekipor. Çdo anëtar i stafit ka rol të rëndësishëm në ruajtjen e sigurisë së sistemit,” thotë përgjegjësi i punës Zoran Danevski, i cili ka më shumë se dhjetë vjet përvojë..

Me urdhër nga Qendra Nationale Dispeçerike, ekipi në TS Dubrovë kryen të gjitha ndërhyrjet e nevojshme që kërkon sistemi në atë moment, në përputhje me procedurat strikte të sigurisë.



Siguria dhe mbrojtja si prioritet kryesor

Në TS Dubrovë i kushtohet vëmendje e veçantë sigurisë në punë dhe mbrojtjes së pajisjeve. E gjithë pajisja është e miratuar dhe e kontrolluar nga Shërbimi për siguri dhe shëndet në punë, ndërsa rregullisht testohet edhe pajisja mbrojtëse – çizme, doreza, helmata dhe pajisje për tokëzim.

Ekipi i punës posedon të gjitha certifikatat për manipulim me pajisje elektroenergjetike dhe ka kaluar të gjitha testet e brendshme të detyrueshme para se të punojë në mënyrë të pavarur në ndërrime.

Siguri me instalimin e dy transformatorëve



TS Dubrovë disponon me dy transformatorë – një të ri dhe një të rikonstruktuar. Përmes instalimit të një sistemi modern për monitorimin e transformatorëve, ekipi në mënyrë të vazhdueshme ndjek gjendjen dhe funksionimin e tyre



Transformatori i ri ka një rol veçanërisht të rëndësishëm në sigurimin e funksionimit stabil të TS Dubrovo dhe në transmetimin e sigurt të energjisë elektrike. Ai bën pjesë në grupin e transformatorëve të gjeneratës së fundit, të pajisur me teknologji të avancuar dhe zgjidhje moderne teknologjike.

Data Disaster Recovery Center – investim në sigurinë digjitale

Përveç infrastrukturës energjetike, në TS Dubrovë po punohet intensivisht edhe për qendrën e re Data Disaster Recovery Center, një projekt strategjik i ShA MEPSO, me qëllim ngritjen e nivelit të sigurisë digjitale, efikasitetit dhe rezistencës së sistemit elektrotransmetues.

Me këtë projekt forcohet drejtpërdrejt infrastruktura nacionale energjetike dhe sigurohet një nivel më i lartë i mbrojtjes së të dhënave kritike dhe proceseve të kompanisë.

Me traditën e gjatë, stafin me përvojë dhe modernizimet e vazhdueshme, TS Dubrovë mbetet një nga shtyllat më të rëndësishme të sistemit të sigurt dhe stabil elektrotransmetues në vend.

GRATË NË ENERGJETIKË

GRUAJA PAS PROJEKTEVE STRATEGJIKE ENERGJETIKE: "FORCA MË E MADHE JANË NJERËZIT "

Intervistë me Anita Jovanova – Koordinatorë për bashkëpunim ndërkombëtar

Pas çdo projekti të rëndësishëm energjetik qëndrojnë vite përkushtimi, njohurie, përgjegjësi dhe pune ekipore. Në rubrikën "Gratë në Energjetikë" bisedojmë me Anita Jovanova, inxhinierë dhe profesioniste shumëvjeçare nga MEPSO, e cila për më shumë se tri dekada ka marrë pjesë aktive në planifikimin dhe realizimin e projekteve kapitale me rëndësi kyçe për stabilitetin energjetik dhe zhvillimin e shtetit.

Nga projektet hidroenergjetike Kozjak , Çebren dhe Shën Petka, deri te zhvillimi i rrjetit modern të transmetimit dhe sistemeve interkonektive, historia e saj profesionale është dëshmi e përkushtimit, vizionit dhe dashurisë për profesionin.

Në intervistë, Jovanova flet për sfidat në sektorin energjetik, rëndësinë e punës ekipore, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe rolin e dijes si kapitali më i rëndësishëm që u transmetohet brezave të rinj të inxhinierëve.

Gjatë karrierës suaj keni marrë pjesë në realizimin e projekteve të rëndësishme kapitale me rëndësi kyçe për pavarësinë dhe stabilitetin energjetik të shtetit. Kur sot i riktheheni fillimeve tuaja profesionale, çfarë ju mbetet motivi më i fortë që ju orientoi drejt energjetikës?

- Një perspektivë e kthyer pas gjithmonë sjell një peshë të veçantë. Kur i rikthehem fillimeve, por edhe të gjitha aktiviteteve dhe ngjarjeve të mëvonshme në karrierën time profesionale, dominojnë emocione të forta, lidhje e sinqertë dhe dashuri e thellë për punën, projektet, njerëzit me të cilët kam punuar dhe vetë kompaninë.



Sigurisht, nuk munguan problemet dhe sfidat e pazakonta, por gjërat e mira, bashkëpunimi me kolegë të mrekullueshëm dhe sukseset e arritura gjithmonë kanë qenë më të forta dhe me kalimin e kohës i kanë lënë në hije të gjitha vështirësitë, sikur të mos kishin ekzistuar kurrë.

Ndjenja e përmbushjes profesionale nuk më ka braktisur asnjëherë. Edhe pas tri dekadash, mbetem mirënjohëse për mundësinë që të jem pjesë e sektorit elektroenergjetik, duke filluar nga ish-Elektroekonomia e Maqedonisë, institucion që atëherë, por edhe sot përmes pasardhësve të saj, ndër të cilët është edhe MEPSO, përfaqëson simbol të profesionalizmit,

stabilitetit dhe reputacionit në energjetikë. Të jesh pjesë e një mjedisi të tillë, të njohur ndërkombëtarisht, për mua gjithmonë ka qenë dhe mbetet një nder i madh. Po aq e rëndësishme është edhe ndjenja e përkatësisë ndaj një kolektivi që ndër vite ka arritur rezultate të dukshme, duke kontribuar në pavarësinë dhe stabilitetin energjetik të shtetit.

Rruga ime profesionale filloi me përfshirjen në projekte kapitale dhe strategjike në fushën e prodhimit të energjisë elektrike. Puna në zhvillimin e projekteve si hidrocentralet Kozjak, Çebren, Galishte, Shën Petka, Boshkov Most, Lukovo Pole dhe koncepti i Luginës së Vardarit, nga të cilat një pjesë tashmë janë realizuar, përfaqësonte një shkollë intensive dhe të çmuar, si rrallëherë gjatë një karriere.

Më vonë, rruga profesionale më orientoi drejt transmetimit të energjisë elektrike, një fushë që më solli po aq kënaqësi dhe sfida. Dy dekadat e fundit ia kam kushtuar zhvillimit të planeve dhe programeve, si dhe realizimit të projekteve të transmetimit me rëndësi lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.

Jam e vetëdijshme se do të vijë momenti kur kjo përditshmëri do të mbetet pas meje. Dhe pikërisht për këtë arsye, që tani e di se gjithçka – dinamika, përgjegjësia, puna ekipore dhe ndjenja se po krijohet diçka e qëndrueshme dhe domethënëse – do të më mungojë shumë.



Ju thoni se rruga juaj profesionale ju orientoi drejt transmetimit të energjisë elektrike dhe projekteve interkonektive. Si është ndjenja të jesh pjesë e projekteve me rëndësi nacionale dhe cili projekt ju ka lënë gjurmën më të fortë personale dhe profesionale?•

▪ Siç e përmenda edhe më parë, ndjenja e përkatësisë ndaj një kompanie që ka rol thelbësor në sigurimin e pavarësisë dhe stabilitetit energjetik të shtetit është vërtet e veçantë. Vetëdija se keni qenë pjesë e atij procesi, qoftë edhe si një hallkë e vogël në një sistem shumë më të madh, sjell një ndjenjë të sigurtë krenarie dhe përmbushjeje.

Nga projektet e shumta me rëndësi të jashtëzakonshme nacionale në të cilat kam pasur mundësi të punoj, do ta veçoja projektin për ndërtimin e nënstacionit 400 kV TS Skopje 5. Jo aq për shkak të rëndësisë së tij, edhe pse ajo padyshim është e madhe, por për shkak të dinamikës së jashtëzakonshme të realizimit, specifikave të ndërtimit dhe nivelit të lartë të organizimit, koordinimit dhe profesionalizmit që treguan të gjithë të përfshirët – si kontraktorët, ashtu edhe ekipi i MEPSO-s.

Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat dhe kompleksitetin e një ndërmarrjeje të tillë, fakti që stacioni transformatorik u ndërtua dhe u vu në funksion brenda vetëm një viti përfaqësonte një arritje vërtet të jashtëzakonshme.

Ishte një sfidë profesionale që kërkonte përkushtim maksimal, vendime të shpejta, por të menduara mirë, dhe punë ekipore të përkryer. Sinqerisht, ai mbetet një nga ato momente që nguliten thellë në kujtesën profesionale – një sfidë me një intensitet dhe dinamikë të tillë që, të paktën në përvojën time, nuk është përsëritur deri më sot.

Kur flisni për realizimin e TS Shkup 5, është e qartë se projekte të tilla kërkojnë koordinim dhe organizim serioz. Sa ka ndryshuar sot qasja ndaj

planifikimit dhe realizimit të projekteve komplekse infrastrukturore krahasuar me më parë?

- Qasja ka ndryshuar dhe është avancuar ndjeshëm ndër vite. Sot proceset janë shumë më të strukturuar, më precize dhe më të harmonizuara me standardet moderne ndërkombëtare dhe praktikat më të mira. Nëse më parë shumë gjëra vareshin më tepër nga përvoja individuale dhe aftësia operative për t'u përshtatur, sot kësaj i shtohen metodologji të zhvilluara të menaxhimit të projekteve, procedura më të qarta, menaxhim më i mirë i rreziqeve, planifikim më i detajuar dhe koordinim shumë më i fortë ndërmjet të gjitha palëve të përfshira.

Sigurisht, përvoja mbetet ende një faktor i pazëvendësueshëm, sepse çdo projekt i realizuar sjell njohuri të reja dhe ndërton pjekurinë institucionale.

Por, pavarësisht përparimit në mjetet dhe qasjet, projektet komplekse infrastrukturore gjithmonë sjellin sfida serioze. Këtu bëhet fjalë për afate të gjata kohore, numër të madh palësh të interesuara, procedura rregullatore, kompleksitete teknike, kufizime financiare, si dhe nevojën për marrjen në kohë të vendimeve cilësore në rrethana dinamike.

Veçanërisht në energjetikë, çdo projekt ka rëndësi më të gjerë, sepse nuk përfaqëson vetëm një investim, por pjesë të një sistemi që ndikon drejtpërdrejt në stabilitetin dhe sigurinë e shtetit.

Megjithatë, nëse duhet të veçoj atë që është vërtet kyçe për realizim të suksesshëm, atëherë pa dilemë është puna e ekipore. Asnjë projekt i rëndësishëm nuk është rezultat i angazhimit individual, por i punës së sinkronizuar, besimit të ndërsjellë, komunikimit të hapur dhe bashkëpunimit të vërtetë mes profileve të ndryshme të ekspertëve, institucioneve dhe partnerëve.

Kur kësaj i shtohen profesionalizmi, vizioni i qartë dhe gatishmëria për të mësuar dhe për të zbatuar përvojat më të mira ndërkombëtare, suksesi bëhet një rezultat i pritshëm.

Në atë proces, pa dyshim rol shumë të madh kanë koordinimi dhe bashkëpunimi

ndërkombëtar. Sa ndikon shkëmbimi i përvojave me operatorë dhe institucione të tjera në cilësinë e zgjidhjeve projektuese?



- Të gjitha këto kanë ndikim jashtëzakonisht të madh në cilësinë e zgjidhjeve projektuese, veçanërisht kur bëhet fjalë për projekte komplekse infrastrukturore. Nëse më herët theksova se qasja bashkëkohore ndaj menaxhimit të projekteve po bëhet gjithnjë e më e sofistikuar dhe bazohet në praktika të mira, atëherë pikërisht bashkëpunimi ndërkombëtar është një nga mekanizmat kyç përmes të cilëve këto praktika transmetohen, përvetësohen dhe avancohen.

Në kushtet e sotme të punës, sidomos në sektorin energjetik, rrallëherë ndonjë projekt i rëndësishëm mund të shihet i izoluar, vetëm në një kontekst lokal. Sistemet energjetike janë të ndërlidhura mes vete, standardet teknike janë të harmonizuara, ndërsa projektet shpesh kanë dimension rajonal ose më të gjerë strategjik. Në rrethana të tilla, shkëmbimi i përvojave me institucione dhe ekspertë nga vende të tjera mundëson shmangien e gabimeve tashmë të njohura, zbatimin e zgjidhjeve të dëshmuara dhe një perspektivë më të gjerë gjatë marrjes së vendimeve.

Njëkohësisht, koordinimi i mirë është ai që e shndërron dijen dhe përvojën në rezultat

konkret. Edhe zgjidhjet më të mira teknike mund të hasin vështirësi nëse mungon komunikimi në kohë, përcaktimi i qartë i roleve dhe veprimi i harmonizuar ndërmjet të gjitha palëve të përfshira.

Përvoja ime tregon se rezultatet më të mira gjithmonë arrihen atëherë kur ekziston gatishmëri për mësim të vazhdueshëm, shkëmbim profesional dhe bashkëpunim të mirëfilltë, gjë që na rikthen sërish te e njëjta thelbësore – teknologjia, metodologjitë dhe përvoja janë jashtëzakonisht të rëndësishme, por njerëzit, besimi dhe sinergjia ekipore janë ato që bëjnë që projektet të kenë sukses të vërtetë.

Nëse merret parasysh i gjithë rrugëtimi juaj profesional dhe projektet në rrjetin e transmetimit, si e vlerësoni zhvillimin e MEPSO-s dhe çfarë kompanie shihni në vitet që vijnë?

- Nëse zhvillimin e rrjetit të transmetimit duhet ta përshkruaj në një mënyrë tjetër, më pak teknike, do të thosha se është një histori pjekurie, vizioni dhe këmbënguljeje. Rrjeti i transmetimit nuk ndërtohet brenda natës, e as zhvillimi i tij nuk matet vetëm me kilometra linjash apo numër nënstacionesh. Ai është një sistem i gjallë që rritet bashkë me nevojat e shtetit, me zhvillimin e teknologjisë dhe me ndryshimet që sjell koha.

Në dekadat e fundit, të gjithë kemi qenë dëshmitarë të një zhvillimi të rëndësishëm – nga një sistem që kryesisht ishte i orientuar drejt sigurimit të stabilitetit brenda kufijve kombëtarë, në një rrjet që sot ka një rol shumë më të gjerë, si pjesë e një hapësire elektroenergjetike rajonale dhe evropiane të ndërlidhur.

Pas këtij zhvillimi qëndrojnë shumë dije, përgjegjësi, profesionalizëm dhe puna e qetë, por e përkushtuar e gjeneratave të tëra profesionistësh.


Ndërsa kur flas për MEPSO-n në vitet që vijnë, e shoh si një operator transmetimi edhe më të fortë, më modern dhe më të integruar – një kompani që jo vetëm do ta ndjekë zhvillimin energjetik, por do ta formësojë atë në mënyrë aktive.

Sot energjetika po ndryshon me shpejtësi të jashtëzakonshme – burimet e ripërtëritshme, digjitalizimi, teknologjitë e reja, kërkesat e reja për fleksibilitet dhe siguri – dhe pikërisht për këtë arsye roli i sistemit të transmetimit bëhet edhe më i rëndësishëm.

Por, nëse kam mësuar diçka gjatë viteve, ajo është se forca e vërtetë e një kompanie nuk qëndron vetëm te infrastruktura, por te njerëzit. Prandaj, MEPSO-n e shoh si një kompani që do të vazhdojë të zhvillohet teknologjikisht, por që do ta ruajë edhe vlerën e saj më të madhe – dijen, profesionalizmin dhe përkushtimin e njerëzve që e mbajnë sistemin funksional çdo ditë.

Gjatë gjithë bisedës e keni theksuar disa herë rëndësinë e dijes, bashkëpunimit dhe qasjes profesionale. Puna juaj njihet edhe jashtë MEPSO-s, prandaj çfarë mendoni se është thelbësore për të ndërtuar një kredibilitet të tillë profesional?

- Kredibiliteti profesional, sipas meje, nuk është diçka që ndërtohet me qëllim që të jetë i njohur, por diçka që lind natyrshëm nga mënyra se si e kryeni punën tuaj gjatë viteve. Ai nuk krijohet përmes titujve apo anëtarësimeve formale, megjithëse edhe ato kanë rëndësinë e tyre, por përmes qëndrueshmërisë, dijes, integritetit dhe marrëdhënies që ndërtoni me njerëzit. Në çdo profesion, e veçanërisht në tonin, njerëzit e kuptojnë shumë shpejt nëse pas fjalëve tuaja ka substancë, nëse e dini për çfarë po flisni, nëse merrni përgjegjësi dhe nëse jeni të gatshëm të mësoni, edhe pas shumë vitesh përvojë. Mendoj se kredibiliteti ndërtohet pikërisht kështu – në heshtje, përmes punës, përmes



rezultateve, por edhe përmes mënyrës se si silleni me kolegët, partnerët dhe komunitetin profesional. Për mua personalisht, ka qenë gjithmonë e rëndësishme të mbetem e hapur ndaj njohurive të reja dhe shkëmbimit të përvojave, sepse zhvillimi profesional nuk është kurrë një proces i përfunduar. Anëtarësimi në organizata vendore dhe ndërkombëtare e shoh pikërisht si një mundësi për të mësuar, për dialog profesional dhe për një kuptim më të gjërë të proceseve që formësojnë energjetikën.

Por, nëse duhet të veçoj diçka thelbësore, do të thosha se kredibiliteti ndërtohet kur njerëzit e dinë se mund t'ju besojnë – si profesionalisht, ashtu edhe njerëzisht. Dhe një besim i tillë nuk fitohet menjëherë; ai ndërtohet me durim, përmes viteve të punës së përkushtuar, shumë përpjekjeje dhe një raporti të sinqertë me profesionin

Ju thoni se zhvillimi profesional nuk përfundon kurrë dhe se dija duhet të ndahet vazhdimisht. Sa e rëndësishme është që përvoja e fituar në projekte të tilla t'u transmetohet inxhinierëve të rinj?

- Inxhinieria është një nga ato profesione ku dija nuk është vetëm teori, por edhe ndjenjë për

vlerësim, intuitë e ndërtuar nga përvoja, kuptim i kontekstit dhe aftësi për të marrë vendime në situata komplekse. Këto janë gjëra që jo gjithmonë mund të mësohen nga librat apo manualet, por fitohen kur dikush të jep hapësirë të marrësh pjesë, të pyesësh dhe madje të gabosh për të mësuar.

Pjesa më e vlefshme e përvojës profesionale, në

fakt, transmetohet përmes bashkëpunimit të drejtpërdrejtë, dialogut, zgjidhjes së përbashkët të problemeve dhe përmes mundësisë që kolegët më të rinj ta ndiejnë nga afër gjithë procesin – jo vetëm si detyrë teknike, por si një profesion i gjallë me dinamikën, përgjegjësinë dhe peshën e vet.

Besoj se çdo brez ka detyrimin të lërë diçka pas vetes – jo vetëm projekte të realizuara dhe infrastrukturë të ndërtuar, por edhe dije, vlera dhe kulturë profesionale. Kënaqësia më e madhe nuk është vetëm të shohësh një projekt të përfunduar me sukses, por edhe të shohësh një inxhinier të ri që me siguri dhe vetëbesim ecën përpara, duke bartur një pjesë të asaj që ke ndarë me të.

Ndoshta ky është edhe vazhdimësia më e bukur në profesionin tonë – vetëdija se sistemet që ndërtojmë do të vazhdojnë të funksionojnë, por edhe se njerëzit që vijnë pas nesh do t'i përmirësojnë me energjinë, dijen dhe idetë e tyre të reja. Në këtë ka diçka veçanërisht të bukur dhe qetësuese: ndjesia se puna nuk përfundon me ne, por vazhdon të jetojë përmes brezave të ardhshëm të inxhinierëve.


NJË DITË ME DEPARTAMENTIN E REVITALIZIMIT

PREVITALIZIMI – FORCA E QETË PAS SISTEMIT TË SIGURT TË TRANSMETIMIT

Përgatiti: Irina Daskalovska Qosevska

“Kjo është punë ekipore. Dokumentacioni i projektit vendos themelet, shërbimi elektro siguron korrektësinë teknike dhe funksionalitetin, ndërsa përgatitja ndërtimore krijon kushtet që gjithçka të realizohet në terren. Vetëm me koordinim të mirë mund të sigurohet realizim i sigurt dhe në kohë.”

Në sistemin e transmetimit, siguria nuk është rastësi, por rezultat i kujdesit të vazhdueshëm, planifikimit dhe modernizimit në kohë. Pikërisht aty fillon historia e Departamentit për Revitalizim në ShA MEPSO. Me udhëheqësin e departamentit, Tomislav Lazarov, inxhinier elektrik dhe magjistër i energjetikës, me 25 vite përvojë profesionale, kalojmë përmes një dite tipike pune të mbushur me koordinim, sfida teknike dhe vendime me përgjegjësi të lartë



“Roli ynë është t’i japim jetë të re pajisjeve ekzistuese,” shpjegon Lazarov. “Në vend që të ndërtohet nga fillimi, shpesh zgjidhet revitalizimi, një proces që nënkupton

modernizim, rindërtim dhe zëvendësim të elementeve kritike në nënstacione dhe në rrjetin e transmetimit. Qëllimi është i qartë: siguri më e madhe me kosto optimale,” shton ai.



Dita në departament fillon me një briefing të shkurtër. Rishikohen projektet aktuale, nga përgatitja e dokumentacionit deri te zëvendësimi i pajisjeve të tensionit të lartë, kontrollohen afatet dhe shpërndahen detyrat. *“Duhet të dimë saktësisht kush çfarë punon dhe cilat janë prioritetet,”* thotë Lazarov.

Puna rrallë është e njëjtë. Në varësi të sezonit, ekipi është ose në terren ose në zyrë. Nga marsi deri në tetor, kur kushtet e lejojnë, aktivitetet zhvillohen kryesisht në terren, në nënstacione, ku çdo ndërhyrje kërkon precizitet dhe standarde të larta sigurie. Pjesa tjetër e vitit i kushtohet analizës, përgatitjes dhe harmonizimit të projekteve të reja dhe ekzistuese

Pas çdo projekti të suksesshëm qëndron një koordinim i fortë ndërmjet tre segmenteve kryesore: Shërbimit për dokumentacion projektues, Shërbimit elektro dhe Njesisë për përgatitje ndërtimore. “Kjo është punë ekipore,” thekson Lazarov. Dokumentacioni projektues vendos themelet përmes zgjidhjeve ideore dhe ekzekutive, shërbimi elektro siguron korrektësinë teknike dhe funksionalitetin e pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse, ndërsa përgatitja ndërtimore krijon kushtet që gjithçka të realizohet fizikisht në terren.



“Komunikimi ndërmjet shërbimeve zhvillohet përmes koordinimit të rregullt, dokumentacionit teknik, komunikimit operativ gjatë realizimit dhe procedurave formale, me qëllim zbatimin e sigurt dhe të harmonizuar të projekteve. Kemi vazhdimisht takime koordinuese, brifingje ditore dhe javore, si dhe harmonizim të aktiviteteve dhe afateve – në këtë mënyrë dakordojmë edhe kush çfarë merr përsipër,” thekson Lazarov.

OcVeçanërisht e rëndësishme, sipas tij, është roli i shërbimit elektro, ku lidhjet sekondare nuk janë vetëm kabllim, por “logjikë e komandimit dhe mbrojtjes”. Një gabim i vogël këtu mund të ketë pasoja serioze, prandaj vëmendja ndaj detajeve është kyçe, i përpikt Lazarov.

Fokusi i shërbimeve

- Shërbimi për dokumentacion projektues udhëheq projektin. Roli i tij është përgatitja e projekteve ideore dhe ekzekutive, të cilat përfshijnë skema njëpolare, plane të vendosjes, llogaritje dhe harmonizim me standardet dhe rregulloret në fuqi. Koordinimi me shërbimet e tjera është thelbësor, sepse pa koordinim të

mirë, edhe një projekt i mirë mund të realizohet keq. Koordinimi është gjithashtu thelbësor sepse siguron zgjidhje teknike korrekte, realizim të sigurt, shmangie të gabimeve, zbatim në kohë dhe vënie të sigurt në punë.

- Shërbimi elektro kryen më shpesh aktivitete në terren si mirëmbajtja, servisi dhe zëvendësimi i ndarësve dhe ndërprerësve, lidhjet sekondare, defektet në sinjalizim/bllokada, testimet funksionale dhe pjesëmarrja në vënie në punë të pajisjeve të reja të montuara. Revitalizimi kontribuon në siguri përmes reduktimit të defekteve, rritjes së besueshmërisë së pajisjeve, përmirësimit të mbrojtjes dhe komandimit, si dhe parandalimit të avarive më të mëdha në sistem.

- Njësia për përgatitje ndërtimore. përfshin përgatitjen e lokacionit, themelet, infrastrukturën kabllore, adaptimet konstruktive, logjistikën dhe harmonizimin e kushteve për realizim të sigurt dhe në kohë të projektit. Pa përgatitje të mirë ndërtimore, realizimi mund të vonohet ose të hasë probleme teknike. Sfidat më të shpeshta në terren janë gjendjet e paparashikuara teknike, ndërprerjet e kufizuara, puna në kushte të larta sigurie, problemet gjatë montimit dhe nevoja për koordinim të shpejtë dhe zgjidhje në vend.

Sfidat dhe përgjegjësia

Sfidat janë pjesë e përditshmërisë – puna me pajisje të vjetra, mundësi të kufizuara për



ndërprerje, defekte të paparashikuara dhe koordinim kompleks mes ekipeve të ndryshme. Megjithatë, pikërisht këto situata e bëjnë punën dinamike. “Motoja jonë është parandalimi në vend të reagimit,” thotë Lazarov duke theksuar rëndësinë e mirëmbajtjes së rregullt dhe

kontrolleve në kohë. Pavarësisht sfidave, kënaqësia më e madhe, sipas tij, vjen në fund të procesit, kur projekti realizohet dhe pajisjet vihen në punë në mënyrë të sigurt. *"Ndjenja se kemi kontribuar në sigurinë e sistemit është e pazëvendësueshme,"* thotë ai.



Motivi profesional dhe perkushtimi inxhinierik

Për Lazarov, motivimi qëndron në faktin se ai punon në një sistem me rëndësi thelbësore për funksionimin e shtetit.

"Motivimi im është mundësia për të punuar në një sistem që është thelbësor për sigurinë e rrjetit elektroenergetik. Fusha e revitalizimit më tërheq sepse bashkon njohuritë teknike, zgjidhjen e problemeve reale dhe përmirësimin afatgjatë të sistemit. Veçanërisht më intereson modernizimi i pajisjeve si ndarësit dhe ndërprerësit, sepse kontribuon drejtpërdrejt në sigurinë e sistemit. Motivimi im personal është zhvillimi profesional në një fushë që kërkon përgjegjësi, njohuri teknike dhe koordinim ekipor," përfundon ai.

Revitalizimi, sipas tij, është një ndërthurje e njohurive, përvojës dhe zgjidhjes praktike të problemeve reale – një fushë ku çdo ditë sjell mësim të reja. Ai u rekomandon inxhinierëve të rinj të jenë kureshtarë dhe këmbëngulës: *"Kjo fushë kërkon kombinim të teorisë dhe praktikës, prandaj është e rëndësishme të kuptohet*

sistemi real, jo vetëm libri. Gjithashtu do t'u rekomandoja të mësojnë nga kolegët me përvojë, të jenë të orientuar drejt punës ekipore dhe ta shohin çdo projekt si mundësi për zhvillim. Përvoja praktike në terren është ajo që e formëson më shumë një inxhinier."

Një ditë me Departamentin e Revitalizimit tregon se pas një sistemi të qëndrueshëm elektroenergetik qëndron një ekip që planifikon dhe realizon me kujdes çdo ditë, hap pas hapi, me një qëllim të qartë: një rrjet transmetues të sigurt dhe modern.



"Roli ynë është t'i japim jetë të re pajisjeve ekzistuese. Në vend që të ndërtohet nga fillimi, shpesh zgjidhet revitalizimi – një proces që nënkupton modernizim, rindërtim dhe zëvendësim të elementeve kritike. Qëllimi është i qartë: siguri më e madhe me kosto optimale."



KONFERENCA, DEBATE

VIZITË NË INSTITUTIN E ELEKTROTEKNIKËS “MILAN VIDMAR” NË LUBJANË

Përfaqësues të lartë të ShA MEPSO realizuan një vizitë pune në Institutin e Elektroteknikës “Milan Vidmar” në Lubjanë, Slloveni. Qëllimi i vizitës ishte njohja me punën e këtij institucioni të njohur në fushën e energjetikës, i themeluar në vitin 1948, i cili paraqet një nga qendrat kryesore shkencore dhe kërkimore në rajon.



Në kuadër të vizitës u mbajt një takim pune me drejtorin e institutit, dr. Urosh Kerin, ku u prezantua roli dhe pozicioni i institutit në sektorin energjetik slloven, si dhe bashkëpunimi i tij shumëvjeçar me Operatorin slloven elektrotransmetues – ELES.



Ekipe profesionale të institutit prezantuan projektet aktuale, zgjidhjet moderne teknologjike dhe sistemet e tyre softuerike, të cilat kanë përdorim të gjerë në disa shtete evropiane. Interes

të veçantë tek përfaqësuesit e MEPSO-s ngjalli sistemi SCALAR – një sistem i avancuar për parashikimin, detektimin dhe analizën e shkarkimeve atmosferike, i zhvilluar nga vetë instituti.



“Me implementimin e këtij sistemi në MEPSO do të mundësohej detektim dhe lokalizim i saktë i rrufeve, si dhe analizë dhe parashikim i shkarkimeve atmosferike që ndikojnë drejtpërdrejt në defektet e linjave të transmetimit. Nga ana tjetër, sistemi do të lehtësonte ndjeshëm intervenimet gjatë defekteve dhe do të kontribuonte në rritjen e parashikueshmërisë dhe sigurisë në operim”, theksoi Vase Jovevski, drejtor i Njësisë së ORrT-së.



MEPSO NË TRAJNIMIN OPC/STA NË PRAGË

Në periudhën nga 3 deri më 4 mars në Pragë, Republika Çeke, u mbajt trajnimi i specializuar „OPC/STA Basic Pan-EU”, i organizuar nga kompania e njohur teknologjike Unicorn. Në këtë trajnim morën pjesë edhe përfaqësues të ShA MEPSO, së bashku me ekspertë nga operatorët evropianë të sistemeve elektrotransmetuese. Eventu ishte i dedikuar për planifikimin e koordinuar të ndërprerjeve (Operational Planning Coordination – OPC) dhe analizës së adekuacisë afatshkurtër të sistemit (Short-Term Adequacy – STA) në nivel pan-evropian. Përmes punës praktike me mjete softuerike të specializuara, pjesëmarrësit patën mundësi të avancojnë njohuritë e tyre për zbatimin e metodologjive dhe procedurave të ENTSO-E, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në sigurimin e stabilitetit dhe besueshmërisë së sistemit elektroenergjetik evropian.

Trajnimi mundësoi shkëmbim përvojash dhe praktikash të mira ndërmjet pjesëmarrësve, me qëllim përf forcimin e mëtejshëm të koordinimit rajonal, integritetit dhe sigurisë së rrjetit elektroenergjetik ndërkombëtar.



TRANSFORMIMI ENERJTIK DHE DIGJITALIZIMI NË FOKUS TË ERRA 2026



Drejtori i OST-së, Sashko Lakinski, mori pjesë në konferencën e 23-të vjetore të ERRA-së (Energy Regulators Regional Association), e cila u mbajt më 27 dhe 28 prill 2026 në Bratislavë, Slovaki.

Konferenca, e cila këtë vit shënoi jubileun e 25-vjetorit të ERRA-së, bashkoi rregullatorë nacional energjetik, operatorë sistemesh,

përfaqësues të kompanive energjetike, investitorë dhe ekspertë të sektorit energjetik, me fokus në transformimin e politikave dhe rregulloreve energjetike.

Sashko Lakinski mori pjesë në sesionin panel “Transforming Transmission and Distribution Networks”, kushtuar investimeve në infrastrukturën energjetike, projekteve ndërkufitare, rrjeteve inteligjente dhe digjitalizimit, modeleve tarifore dhe mekanizmave rregullatorë për nxitjen e zhvillimit të sistemeve elektroenergjetike.

Në kuadër të konferencës u shqyrtuan sfidat aktuale dhe drejtimet e ardhshme për zhvillimin e sektorit elektroenergjetik dhe atij të gazit, me theks të veçantë në modernizimin e rrjeteve energjetike dhe tranzicionin energjetik.

KONFERENCA, DEBATE

ShA MEPSO NË TAKIMIN E LEGAL AND REGULATORY GROUP TË ENTISO-E

Drejtori i Sektorit për çështje juridike dhe të përgjithshme, Ibrahim Ibrahim, së bashku me përfaqësuesit e ShA МЕРСО në Legal and Regulatory Group (LRG) të ENTISO-E, mori pjesë në punëtorinë dhe takim të LRG-së, të mbajtura më 22 dhe 23 prill në Zurich, Switzerland, të organizuara nga Swissgrid.



Një nga temat kyçe ishte raporti i hetimit mbi ndërprerjet në furnizimin me energji elektrike në Spanjë, Portugali dhe

Maqedoninë e Veriut, i cili hapi diskutim për sigurinë dhe koordinimin e sistemeve elektroenergjetike. Paneli i ekspertëve të ENTISO-E vlerësoi se incidenti në Maqedoninë e Veriut nuk është rezultat i një defekti të vetëm, por i një problemi strukturor dhe rajonal të lidhur me tensionet e larta, i cili po bëhet gjithnjë e më i theksuar në Evropën Juglindore. Në fokus të diskutimeve ishin edhe rezultatet e LRG Engagement Survey, niveli i përfshirjes së anëtarëve dhe mundësitë për përmirësimin e bashkëpunimit dhe komunikimit, ndryshimet lidhur me CBAM, si dhe anëtarësimi i TEIAS në ENTISO-E.

Përfundimi i përbashkët i takimit ishte nevoja për koordinim të vazhdueshëm, transparencë dhe forcim të bashkëpunimit ndërmjet të gjitha palëve të përfshira, me qëllim zbatimin efikas të prioriteteve strategjike.

BELGRADE ENERGY FORUM

Në një kohë kur tranzicioni energjetik po e ndryshon gjithnjë e më intensivisht peizazhin energjetik në rajon, *Belgrade Energy Forum 2026* mbledhi bartësit e politikave energjetike, kompanitë dhe ekspertët nga Evropa Juglindore në një diskutim mbi sigurinë e furnizimit, dekarbonizimin dhe ndërlidhjen rajonale.

Në forum mori pjesë edhe zëvendësdrojtori gjeneral Aleksandar Paunoski, i cili foli për rolin gjithnjë e më të rëndësishëm të operatorëve të sistemeve të transmetimit në kushtet e zhvillimit të përshpejtuar të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe nevojave në rritje për integrimin e tyre në rrjetin e transmetimit.

Procesi i tranzicionit energjetik kërkon investime të vazhdueshme në modernizimin dhe forcimin e infrastrukturës së transmetimit, tha ai, me qëllim që të sigurohen besueshmëria, stabiliteti dhe fleksibiliteti më i madh i sistemit elektroenergjetik.

ShA MEPSO punon aktivisht në zhvillimin e infrastrukturës së rrjetit dhe në krijimin e kushteve për kycjen e kapaciteteve të reja prodhuese nga burimet e ripërtëritshme, duke thelluar bashkëpunimin me operatorët e sistemeve të transmetimit nga rajoni.



SINDIKATAT E SHA MEPSO

NDËRKOMBËTARIZIMI I BASHKËPUNIMIT SINDIKAL DHE BETEJË E VAZHDUESHME PËR KUSHTE MË TË MIRA PËR PUNONJËSIT

Sindikatat e Sha edhe gjatë vitit 2026 vazhdon me po të njëjtin rritëm me aktivitetet e saj të orientuara drejt mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve, avancimit të kushteve të punës dhe përmirësimit të standardit jetësor të të punësuarve.

Gjatë periudhës së kaluar, përfaqësues të organizatës sindikale morën pjesë në disa takime dhe konferenca rajonale dhe ndërkombëtare të organizuara nga RETUNSEE, EPSU dhe PSI, ku fokusi kryesor ishte negociimi kolektiv, organizimi sindikal, sfidat me të cilat përballen punëtorët në sektorin energjetik, si dhe nevoja për një luftë të përbashkët për ruajtjen e të drejtave të punëtorëve në kushte të pasigurisë ekonomike dhe energjetike

Veçanërisht i rëndësishëm ishte pjesëmarrja në takimet e mbajtura në Shkup dhe Zagreb, ku sindikatat nga rajoni shkëmbyen përvoja dhe qëndrime lidhur me:

- harmonizimin e pagave me rritjen e kostove të jetesës;
- forcimin e negociimit kolektiv;
- mbrojtjen e organizimit sindikal;
- përmirësimin e standardit të punëtorëve në sektorin publik dhe energjetik



C Sindikatat e Sha MEPSO vazhdon aktivisht edhe përpjekjet për harmonizimin e pagave në përputhje me inflacionin në rritje, kostot e shtuara të jetesës dhe rritjen e vazhdueshme të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve bazë. Në kushte kur shpenzimet reale të jetesës janë rritur ndjeshëm, është e domosdoshme që pagat e të punësuarve të ndjekin zhvillimin ekonomik dhe të sigurojnë një standard dinjtoz jetese.

Sindikata konsideron se puna, profesionalizmi dhe përgjegjësia e të punësuarve në sektorin energjetik duhet të vlerësohen në mënyrë adekuate, veçanërisht duke pasur parasysh rëndësinë e stabilitetit energjetik dhe funksionimit të sistemit elektroenergjetik.

Përveç aktiviteteve për mbrojtje kolektive, Bordi Ekzekutiv i Organizatës Sindikale të Sha MEPSO mori vendim edhe për pagesën e mbështetjes financiare për anëtarët me rastin e festave të ardhshme, me qëllim që të ndihmohet së paku pjesërisht në tejkalimin e sfidave të përditshme financiare me të cilat përballen punëtorët dhe familjet e tyre.

Organizata sindikale mbetet e përkushtuar ndaj funksionimit transparent, pjesëmarrjes aktive në të gjitha proceset që i prekin të punësuarit dhe luftës së vazhdueshme për kushte më të mira pune, paga më të larta dhe trajtim dinjtoz për çdo punëtor.

TË PUNSUARIT DHE MEPSO

Rruga profesionale e **Zhivorad Serafimovski** në MEPSO lidhet me sfidën profesionale dhe dëshirën për të kontribuar në stabilitetin energjetik të shtetit. Si pjesë e ekipit përgjegjës për llogaritjen e kapaciteteve neto të transmetimit (NTC), ai merr pjesë aktive në proceset për shkëmbim të sigurt dhe efikas të energjisë elektrike dhe koordinim rajonal me operatorët fqinjë. Përmes pjesëmarrjes në proceset e koordinatorëve rajonalë të sigurisë (RSC), ai vazhdimisht e avancoon ekspertizën e tij në përputhje me standardet evropiane. Një fokus i veçantë në punën e tij është implementimi i teknologjive të reja dhe optimizimi i rrjetit të transmetimit. Për të, puna në MEPSO nuk është vetëm një proces teknik, por edhe një mision i vazhdueshëm për zhvillim profesional, bashkëpunim ekipor dhe realizim të projekteve të rëndësishme, me një vizion të qartë për modernizimin e mëtejshëm dhe integrimin e sistemit elektrotransmetues të Maqedonisë me tregjet evropiane..



Katerina Shkoro-Nikoliq, e diplomuar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, ndërsa në vitin 1997 e fillon karrierën e saj profesionale.

Angazhimin e saj në ShA MEPSO e fillon në vitin 2009, fillimisht në Sektorin për punë financiare dhe komerciale, ku ushtron detyra në disa pozita dhe fiton përvojë të konsiderueshme profesionale. Nga viti 2025 ajo është pjesë e Sektorit për investime dhe zhvillim, ku ushtron funksionin e udhëheqëses së Shërbimit për bashkëpunim ndërkombëtar. Në kuadër të detyrave të përditshme, ajo merr pjesë aktive në ndjekjen dhe realizimin e investimeve kapitale të ShA MEPSO, duke zhvilluar komunikim të vazhdueshëm me institucione financiare ndërkombëtare, kompani – zbatues të projekteve, si dhe me banka

vendore dhe ministri kompetente. Ajo është anëtare e disa grupeve të punës dhe komisioneve, ku me përkushtimin, profesionalizmin dhe përvojën e saj jep një kontribut të rëndësishëm në forcimin e pozitës së ShA MEPSO si një kompani e suksesshme dhe me reputacion.

Aco Risteski është inxhinier i diplomuar i elektroteknikës në Fakultetin Elektroteknik pranë Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup, me më shumë se 36 vite përvojë në fushën e elektroenergjetikës dhe sistemeve të transmetimit. Karrierën e ka filluar në ESM – Maqedoni, ndërsa që nga viti 2005 është pjesë e ShA MEPSO, ku ka ushtruar disa pozita drejtuese dhe inxhinierike, përfshirë kryeinxhinier, udhëheqës të sektorëve për mirëmbajtje, stacione transformatorike dhe revitalizim, si dhe drejtor i Nj;sis; s; ORrT-së dhe anëtar i Këshillit Drejtues të ShA MEPSO. Ai ka dhënë kontribut të rëndësishëm në përgatitjen dhe realizimin e projekteve për rikonstruktimin dhe revitalizimin e objekteve elektroenergjetike 110 kV dhe 400 kV, si dhe në vendosjen e lidhjes interkonektive 400 kV me Shqipërinë. Posedon licenca për mbikëqyrje, projektim dhe revizion, ndërsa si ekspert gjyqësor në fushën e elektroteknikës është angazhuar nga Byroja për ekspertizë gjyqësore – Shkup. Gjithashtu, ka ndjekur trajnime profesionale dhe seminare në kompani të njohura si Siemens, ABB dhe Končar..



Andrej Josifovski është jurist i diplomuar dhe magjistër në të drejtën afariste në Fakultetin Juridik "Justiniani i Parë" pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi", me provim të dhënë të jurisprudence. Përvojën e tij të parë të punës e fiton në ShA MEPSO në vitin 2013, ku fillon si vullnetar, duke u njohur me funksionimin e shoqërisë dhe duke dhënë mbështetje në aktivitetet aktuale juridike. Që nga viti 2015 është në marrëdhënie të rregullt pune në Shërbimin për Çështje Juridike, ku vazhdimisht e përmirëson përvojën e tij profesionale. Në kuadër të këtij shërbimi, ai merr pjesë aktive në përgatitjen dhe zhvillimin e procedurave gjyqësore, hartimin e akteve juridike, kontratave dhe opinioneve juridike, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të shoqërisë. Përveç detyrave të rregullta të punës, ai merr pjesë aktive në disa grupe pune dhe komisione të formuara brenda shoqërisë, si dhe në organe jashtë saj. Ai është anëtar zëvendësues i Legal and Regulatory Group pranë ENTSO-E. Gjithashtu, është një nga personat zyrtarë të ngarkuar për trajtimin e kërkesave për qasje në informata me karakter publik, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie të Shoqërisë..



Sandra Paneva është ekonomiste e diplomuar me përvojë shumëvjeçare pune. Që nga viti 2018 është pjesë e ShA MEPSO, ku fillimisht ka punuar si referente në Shërbimin për bashkëpunim ndërkombëtar, ndërsa më pas vazhdon në Shërbimin për menaxhim të projekteve, në Departamentin për investime dhe zhvillim, në pozitën referente përgjegjëse për financa. Ajo merr pjesë aktive në realizimin e projekteve të financuara nga institucionet financiare ndërkombëtare. Si anëtare e disa grupeve punuese, ajo merr pjesë në përgatitjen e dokumentacionit të tenderëve, vlerësimin e ofertave dhe implementimin e kontratave. Në punën e saj është e angazhuar në projekte të financuara nga Banka Botërore dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim..

Erdol Prespa është inxhinier i diplomuar në Fakultetin e Elektroteknikës dhe Teknologjive të Informacionit, drejtimi informatikë dhe inxhinieri kompjuterike. Ai është i punësuar si inxhinier përgjegjës për sigurinë e rrjeteve në sektorin IT në ShA MEPSO, ku kujdeset për funksionimin e sigurt dhe stabil të infrastrukturës së rrjetit. Në kuadër të aktiviteteve të përditshme, ai monitoron në mënyrë aktive kërcënimet e mundshme kibernetike, reagon në kohë ndaj incidenteve të sigurisë dhe zbaton politika dhe teknologji të avancuara për mbrojtjen e të dhënave. Kryen analiza të detajuara të trafikut të rrjetit me qëllim zbulimin në kohë të aktiviteteve të dyshimta dhe rreziqeve të mundshme. Ai bashkëpunon me ekipe të tjera brenda kompanisë për përmirësimin e nivelit të përgjithshëm të sigurisë IT, ndërsa njëkohësisht përditëson dhe mirëmban rregullisht mjetet dhe sistemet e sigurisë. Gjithashtu, merr pjesë aktive në planifikimin dhe implementimin e zgjidhjeve të reja të rrjetit, duke u siguruar për përputhshmërinë me standardet dhe rregulloret relevante në fushën e sigurisë kibernetike. Me punën e tij, ai kontribuon drejtpërdrejt në sigurinë, besueshmërinë dhe stabilitetin e sistemit energjetik në vend.



LAJME NGA BOTA

BE-ja ME PAKETË TË RE MASASH PËR PAVARËSI ENERGETIKE DHE MBROJTJE NGA GODITJET E ÇMIMEVE



Komisioni Evropian prezantoi një strategji të re "AccelerateEU", e cila synon të zvogëlojë varësinë nga importi i lëndëve djegëse fosile dhe të zbusë pasojat e rritjes së çmimeve të energjisë për qytetarët dhe industrinë. Sipas Komisionit, për shkak të tensioneve gjeopolitike, BE-ja ka shpenzuar 24 miliardë euro shtesë për importin e energjisë pa marrë sasi shtesë. Qëllimi i masave të reja është të sigurojnë mbështetje afatshkurtër, por edhe stabilitet afatgjatë energjetik. Sipas presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, përshpejtimi i tranzicionit drejt energjisë së pastër dhe vendore është kyç për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e Evropës.

Masat përfshijnë koordinimin e rezervave të gazit dhe naftës, ndihmë financiare për kategoritë më të rrezikuara, si dhe përshpejtimin e elektrifikimit dhe investimeve në burime të ripërtëritshme të energjisë. Me këtë strategji, BE-ja synon të forcojë pavarësinë energjetike dhe të zvogëlojë ekspozimin ndaj krizave të ardhshme në tregjet globale të energjisë. Rritja e çmimeve të karburanteve, energjisë elektrike dhe energjensëve i detyroi vendet e BE-së të ndërmarrin masa të ndryshme për mbështetjen e qytetarëve dhe ekonomisë. Gjermania dhe Italia vendosën të ulin taksat mbi karburantet dhe të ofrojnë ndihmë të drejtpërdrejtë financiare, ndërsa Franca prezantoi një paketë subvencionesh. Kroacia dhe Sllovenia zbatojnë kufizime administrative të çmimeve të karburanteve dhe energjisë elektrike. Serbia dhe Hungaria gjithashtu përdorin kontroll shtetëror të çmimeve, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina mbështetet më shumë në taksat më të ulëta. https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_26_629


GJIGANTI I RI ENERGETIK – NË KINË NISI PUNËN CENTRALI MË I MADH HIBRID NË BOTË

Në pjesën veriperëndimore të Kinës është vënë në funksion centrali më i madh hibrid në botë, i cili kombinon energjinë e erës dhe të diellit, me kapacitet të përgjithshëm prej 6 GW. Kompleksi përfshin një park me erë prej 4.5 GW dhe një central solar prej 1.5 GW. Sipas Envision Energy, centrali do të prodhojë më shumë se 12 TWh energji elektrike të gjelbër në vit. Energjia elektrike do të transmetohet drejt rajoneve industriale të bregdetit lindor të Kinës përmes linjave me tension ultra të lartë.

Projekti është pjesë e aktiviteteve më të gjera të Envision Group, e cila më parë vuri në funksion edhe sistemin më të madh të baterive për ruajtjen e energjisë me kapacitet prej 4 GWh. Ndërtimi ishte sfidues për shkak të terrenit malor dhe shkretinor, por me zgjidhje teknike të avancuara, logjistike të optimizuara dhe turbina të specializuara, kompleksi u realizua me sukses brenda një periudhe të shkurtër.

<https://www.energetika-net.com/obnovljivi-izvori/u-kini-pokrenuta-najveca-hibridna-elektrana-na-svijetu>

REAKTORËT E VEGJËL MODULARË MES AMBICIES DHE PASIGURISË: ÇEKIA NIS PROJEKTIN NË TEMELIN



Kompania britanike Rolls-Royce SMR dhe kompania kombëtare energjetike ČEZ Group nënshkruan marrëveshje për fillimin e aktiviteteve për ndërtimin e reaktorit të parë të vogël modular (SMR) në Çeki, i cili do të ndërtohet pranë centralit bërthamor Temelín Nuclear Power Station. Me këtë projekt, që ka edhe rëndësi më të gjerë gjeopolitike, të dyja kompanitë planifikojnë zhvillimin e kapaciteteve energjetike deri në 3 gigavat energji elektrike, duke e pozicionuar vendin ndër liderët në zbatimin e kësaj teknologjie në Evropë.

Paralelisht, Evropa po i shqyrton gjithnjë e më intensivisht reaktorët e vegjël modularë si një zgjidhje potenciale për sigurimin e energjisë më të lirë dhe me emetime të ulëta karboni.

Megjithatë, teknologjia ende është në zhvillim dhe përballet me shumë sfida, përfshirë kostot e larta fillestare, përzgjedhjen e lokacioneve dhe sigurimin e karburantit bërthor.

Edhe pse përparësia e SMR-ve është mundësia për prodhim serik dhe ulje të kostove në afat të gjatë, këta reaktorë aktualisht funksionojnë në numër të kufizuar, kryesisht në Rusi dhe Kinë.

Pavarësisht potencialit, ekspertët paralajmërojnë se zhvillimi i kësaj teknologjie kërkon materiale të reja, standarde të rrepta sigurie dhe zinxhirë të qëndrueshëm furnizimi me karburant bërthamor.

Projekti në Republikën Çeke shihet si një test për të ardhmen e kësaj teknologjie, e cila sjell pritshmëri të mëdha, por edhe pasiguri nëse do të bëhet një burim kyç energjie apo do të mbetet në fushën e zgjidhjeve eksperimentale.

(<https://balkangreenenergynews.com/rolls-royce-smr-to-start-works-with-cez-on-small-modular-reactors/>)

TRUMP SHTYN RITJEN E PRODHIMIT TË LËNDËVE DJEGËSE FOSILE NË SHBA

Presidenti i Shteteve të Bashkuara Donald Trump, nënshkroi një seri memorandumesh që parashikojnë zgjerimin e prodhimit vendas të naftës, qymyrit dhe gazit natyror, me arsyetimin se stabiliteti energjetik është kyç për sigurinë kombëtare.

Në dokumente theksohet se furnizimi i pamjaftueshëm me energji e bën vendin të cenueshëm, prandaj është e nevojshme forcimi i kapaciteteve industriale dhe energjetike, veçanërisht në kontekstin e mbrojtjes.


Masat përfshijnë aktivizimin e mekanizmave nga Ligji për prodhimin për nevojat e mbrojtjes, si dhe udhëzime për Ministrinë e Energjetikës për

mbështetjen e projekteve të lidhura me lëndët djegëse fosile.

Paralelisht, rritja e çmimeve të karburanteve dhe ushqimeve po krijon presion shtesë mbi qytetarët, gjë që mund të ndikojë në gjendjen ekonomike.

Sipas vlerësimeve, çmimet e ushqimeve në vitin 2026 do të vazhdojnë të rriten, mbi mesataren e dy dekadave të fundit.

Këto vendime vijnë në kushte tensionesh globale dhe paqëndrueshmërie në tregun e naftës, gjë që e forcon edhe më shumë nevojën për furnizim të sigurt vendas me energji. <https://www.theguardian.com/us-news/2026/apr/20/trump-memos-domestic-fossil-fuels-defense>



OPERATOR I SISTEMIT
ELEKTROTRANSMETUES
Rr. Maksim Gorki nr. 4, 1000 Shkup

WWW.MEPSO.COM.MK

MEPSO